



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI
KOMISIONERI

Nr. 363/16 Prot.

Tiranë, më 19.08.2026

V E N D I M

Nr. 231, Datë 19.08.2026

Bazuar në ligjin 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi është regjistruar ankesa nr. 51, datë 17.02.2026¹, e paraqitur nga znj. M.D kundër Shkollës 9-vjeçare “Niket Dardani”, Tiranë, në të cilën pretendohet për diskriminim të djalit të saj D.D.M, për shkak të “aftësisë së kufizuar”, “përgjegjësisë prindërore²” dhe çdo shkak tjetër.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues

Sipas shpjegimeve të dhëna në formularin e ankesës, subjekti ankues ka ngritur pretendime në lidhje me: “Nxënësi D.D.M është fëmijë me vështirësi zhvillimore, me status të njohur zyrtarisht dhe me dokumentacion mjekësor përkatës, si dhe me vendim të Komisionit Biopsikosocial Multidisiplinar. Ankuesja është kujdestare ligjore dhe ndihmëse personale e fëmijës.

1. Me datë 28.08.2025 bën një kërkesë për përshtatje detyre për të kaluar si mësuese ndihmëse e të miturit të saj pasi gjendja e tij emocionale kishte agravuar. Fëmijën e regjistron në një shkollë të re pranë banesës. Deri në 13 tetor qëndron vetë me fëmijën në bankë dhe më pas i caktojnë një mësuese ndihmëse. Fëmija reagon keq, nuk e pranon, shpreh shqetësim dhe ngarkesë emocionale. Prindi vazhdon të qëndroj pranë për ti krijuar stabilitet dhe qetësi gjatë procesit mësimor. Institucioni nis të përshkallëzojë presionin që fëmija të pranonte me çdo kusht një figurë të re.
2. Me datë 03 tetor 2025 - kam dërguar një email zyrtar ku kam shpjeguar karakteristikat e dispraksisë (DCD) dhe ndikimet e saj në funksionimin dhe përfshirjen e fëmijës në procesin

¹ Ankesa është plotësuar me dokumentacionin e dërguar nga ankuesja me email-in datë 23.02.2026.

² Referuar certifikatës familjare datë 23.02.2026, të lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile 373, rezulton se M.D është nëna e D.D.M.

mësimor. Kam kërkuar që ky informacion të ndahet konfidencialisht me mësuesit përkatës dhe të respektohen detyrimet pedagogjike si kohë shtesë, përshtatje metodike, vlerësim sipas arritjeve dhe jo penalizim për shkak të diagnozës dhe shmangie e diskriminimit.

- 3. Me datë 16.10.2025 ankuesja paraqiti kërkesë zyrtare në shkollë për lejin e pranisë së saj në klasë, pezullimin e përkohshëm të mësueses ndihmëse dhe konsultimin me kujdestaren ligjore për çdo vendim që lidhet me fëmijën.*
- 4. Në email-in e datës 20.10.2025 kam theksuar se reagimet e fëmijës përfshijnë, ankth, të qara dhe kapje pas meje gjatë mësimit, duke përsëritur se mësuesja ndihmëse nuk zëvendëson mbështetjen emocionale dhe funksionale që ofroj unë si ndihmës personal dhe se kërkesat janë në funksion të mirëqenies së fëmijës dhe jo pengimit të mësimit. Në periudhën tetor-nëntor 2025, situata u përshkallëzua me ndërhyrje të përsëritura në klasë, presion verbal në prezencë të fëmijës dhe përfshirje të strukturave shtetërore në ambientet e shkollës, duke krijuar pasiguri emocionale për nxënësin.*
- 5. Me datë 29.10.2025, rreth orës së pestë, katin e tretë, punonjëset e shërbimit psikosocial (SHPS) dhe mësuesja ndihmëse dhe nëndrejtoresha ushtruan tryzni e presion për ta detyruar djalit që të qëndrojë me mësuese ndihmëse, derisa ai u frikësua dhe filloi të qajë, sjellje kjo që konsiderohet e papranueshme dhe jashtë standardeve profesionale. Ky episod gjithashtu është i dokumentuar nga kamerat e sigurisë kati i 3-të në korridor.*
- 6. Në datë 31.10.2025, në orën e parë të mësimit, unë u përballa me një sjellje të papërshtatshme psikologjike dhe verbale nga personeli i SHPS, në prani të fëmijës, duke ushtruar presion të vazhdueshëm për rreth 40 minuta në klasën e djalit, situatë kjo e cila është kapur nga kamerat e sigurisë të vendosura në ambientet e shkollës. Jam përndjekur për javë me radhë me thirrje të shpeshta pa kriter në zyrën e SHPS apo drejtueses, me komunikime shkresore të panevojshme dhe me prezencë të vazhdueshme të stafit të SHPS brenda klasës së djalit, duke ushtruar presion që im bir të pranojë mësuesen ndihmëse, një figurë e panjohur për të, gjë që ka çuar në shqetësim emocional, dëmtim sjellor dhe që ndikonte në frekuentim të rregullt të shkollës nga ana e fëmijës tim si pasojë e ushtrimit të presionit verbal nga SHPS, e cila nuk shërbente për qetësimin e situatës.*
- 7. Pas përshkallëzimit të tensionit në mjedisin arsimor me anë të një urdhri nga drejtoria e shkollës fëmija im është lënë jashtë shkollës për 6 javë duke urdhëruar që të mbyllej dera e shkollës përpara fytyrës së tij, duke i mohuar qasjen në mësim.*
- 8. Në mënyrë persistente, punonjëset e SHPS kanë përdorur gjuhë jo profesionale ndaj meje si prind, përfshirë fyerje dhe akuza të pavërteta, duke cenuar nderin dhe reputacionin tim para fëmijës tim e shokëve të tij të klasës dhe para stafit mësimor të shkollës, gjë e cila është e papranueshme dhe diskriminuese. Presion i vazhdueshëm dhe ndërhyrje të papranueshme brenda orarit të mësimit ku punonjëset e SHPS më ndjekin dhe më shqetësojnë vazhdimisht, përfshirë edhe gjatë orarit të mësimit. Ato futen në ambientet e klasës duke kërkuar dorëzimin e telefonit edhe pse dorëzohet me kohë sipas rregullave.*
- 9. Trajtim i padrejtë dhe diskriminues ndaj fëmijës dhe meje në prezencë të klasës dhe pse nuk jam në marrëdhënie pune me shkollën dhe kam prindër të sëmurë për të cilët kam përgjegjësi direkte, për të cilët pres lajme dhe duhet të kujdesem. Këto punonjëse me veprime të*

- papërshtatshme vijnë dhe ndërhyjnë në mes të orës duke kërkuar me insistim dorëzimin e telefonit apo çantën ku mbaj sendet personale. E gjitha kjo jashtë çdo kompetence.*
- 10. Nga data 3.11.2025 me email e në vazhdim, institucioni i shkollës dhe strukturat arsimore nuk kanë trajtuar me seriozitet kërkesat e mia. Në vend të masave mbrojtëse, është rritur presioni institucional, duke përfshirë komente fyese, intimidime verbale dhe pretendime të paqena, në prani të fëmijës që kanë cenuar mirëqenien e tij emocionale dhe arsimore, e cila përbën moszbatim të detyrimit ligjor për trajtim të barabartë dhe masat pozitive për të luftuar diskriminimin, të parashikuara në nenin 19 të ligjit për drejtuesit e institucioneve arsimore.*
 - 11. Me datë 06.11.2025, institucioni nxori Urdhrin nr. 40, me lëndë “Njoftim mbi respektimin e rregullave të institucionit arsimor dhe rolin e mësueses ndihmëse”. Pas kësaj date filloi përshkallëzimi i tensionit me ndalime verbale dhe presion institucional ndaj prindit dhe fëmijës, i cili refuzonte praninë e mësueses ndihmëse që nga dita e parë.*
 - 12. Email 10.11.2025, kam argumentuar se prania ime në klasë është e ligjshme sipas vendimit të Komisionit Biopsikosocial dhe duhet trajtuar si mjet përfshirës. Kërkesa ime është trajtuar njëanshmërisht, duke krijuar tension emocional të fëmija dhe refuzim të vazhdueshëm për bashkëpunim institucional.*
 - 13. Me datë 19.11.2025 u paraqit kallëzim penal ndaj Znj. M.D dhe u ndalua hyrja në ambientet e shkollës. Si pasojë, fëmija mbeti jashtë procesit mësimor për rreth 6 javë, duke u gjendur në një përjashtim faktik nga arsimi bazë. Në sistemin SMIP, u regjistruan mungesa të shumta 80 dhe u kryen vlerësime pa një proces efektiv mësimor.*
 - 14. Me 05.01.2026 për shkak se fëmija nuk u pranua në institucion, ju drejtova Avokatit të Popullit. Pas kësaj date fëmija u fut në mësim dhe u hartua një marrëveshje me nr. 90, datë 07.01.2026, që legjitimonte veçimin dhe izolimin e fëmijës, e cila nuk u firmos nga znj. M.D.*
 - 15. Menjëherë nisën kërkesat e mësuesve për t’ju nënshtruar testeve. Sërish në email reagoj dhe sqaroj që fëmija ka pësuar traumë dhe ngarkesë emocionale nga kjo situatë.*
 - 16. Në javën e dytë të shkollës djali filloi ti nënshtrohej testeve nën një mbikëqyrje të rreptë nga mësuesja ndihmëse dhe lëndore që nuk më lejonin të ndërveproja dhe të orientoja djalin. Dhe në këtë presion dhe ngarkesë emocionale, djali bëri testet që ishin jashtë standardit të udhëzuesit kurrikular, me mangësi të theksuara në ndërtimin e tyre.*
 - 17. Datë 13.01.2026, me email kam paraqitur shqetësimin tim dhe kam kundërshtuar vlerësimin dhe testimin e fëmijës në kushtet kur ai ka qenë jashtë procesit mësimor për rreth 6 javë dhe ka 83 mungesa të regjistruara për shkak të urdhrin të nxjerrë nga institucioni. Kam kërkuar që çdo test të dakordësohet paraprakisht me mua si ndihmëse efektive e nxënësit gjatë procesit mësimor, në ndërtim dhe formë dhe të zhvillohet në kushte objektive dhe reale mësimore.*
 - 18. Njëkohësisht, jam ballafaquar me refuzime të protokollimit zyrtar të kërkesave dhe refuzim të përshtatjeve të arsyeshme, pavarësisht gjendjes shëndetësore të fëmijës dhe kërkesave racionale arsimore. Në vijim u konstatuan presione dhe vlerësime jotransparente, të papërrputhshme me rezultatet reale të nxënësit.*
 - 19. Me datë 21.01.2025, psikologjia më vuri në dijeni një draft plan PEI i periudhës së dytë Janar-Mars, për të cilin shpreha mosdakordësinë time. Plani draft PEI ishte hartuar nga psikologjia M.P, mësuesi ndihmës F.B (profil biologji), mësuesja kujdestare A.H (profil gjeografi). Si*

- prind i fëmijës, kundërshtova planin PEI për të cilin nuk isha thirrur të diskutoja. Ishte një plan PEI joprofesional, jo i standardizuar dhe në mungesë etike psikologjike dhe pedagogjike.*
20. *Me 22.01.2026, ankohe me tek Urdhri i psikologut në rrugë postare zyrtare për shpërdorim të detyrës, sjellje jo profesionale dhe krijim presioni psikologjik ndaj prindit në cilësinë e shoqëruesit dhe fëmijës nga punonjëset e shërbimit psikosocial të shkollës, M.P dhe N.S.*
21. *Me datë 05.02.2026, fëmijës iu ndërpre mundësia për t'u testuar në disa lëndë. Në email-et e datës 5 dhe 10 shkurt 2026, kam argumentuar ndryshime të menjëhershme të notave pas ankesave zyrtare, pa transparencë dhe vendosje të notave që dyshohet se janë përdorur për presion institucional, ngjarje ku mësuesit vazhduan presionin emocional ndaj fëmijës, duke nxitur reagime emocionale të dukshme.*
22. *Me datë 09.02.2026, u krijua një situatë që ankuesja e konsideron artificiale, me qëllim krijimin e perceptimit të ankesave ndaj saj. Pas komunikimit me email nga ana e ankueses, u hodhën në sistem notat e lëndës Gjuhë Shqipe për periudhën e parë, të cilat nuk përputheshin me vlerësimet e mëparshme në fletore klase dhe shtëpie. Në kushtet kur vlerësimi u pasqyrua me vonesë, pa transparencë dhe pa komunikim paraprak, krijohet bindja e arsyeshme se procesi i vlerësimit nuk ka qenë objektiv dhe ka marrë karakter ndëshkues. Notat e periudhës së parë hidhen me vonesë në SMIP, vetëm pas email-it të 9 shkurtit. Pretendohet mospasqyrim i 6 notave 10-ta në fletore. Janë vendosur në SMIP notat pesë 8-ta dhe 7-të datë 14 janar, pas një mungese 6 javore duke humbur 30 orë gjuhë shqipe dhe periudhë që përkonte dhe me përgatitjen për testet e pezulluara nga institucioni.*
23. *E gjithë kjo situatë solli vlerësim jo objektiv dhe me karakter ndëshkues.*
24. *Email datë 10.02.2026. Ngjarja kryesore: Gjatë orës së Gjuhës Shqipe, mësuesja i kërkon vazhdimisht djalit orën elektronike (smart). Pavarësisht reagimit emocional të fëmijës, insistimi vazhdon. Fëmija shpërthen emocionalisht (qan, godet tavolinën). E detyruar nga rrethana e krijuar e nxjerr nga klasa për ta qetësuar. Kamerat e korridorit vërtetojnë gjendjen e tij.*
25. *Me datë 11.02.2026, në një takim me drejtuesen e ZVA-së, ankueses iu komunikua vendimi i AKAP-it për moslejimin e prezencës së prindit në institucion dhe iu kërkuar transferimi i fëmijës në një shkollë tjetër. E gjithë biseda me tone të larta në prezencë të fëmijës.*
26. *Të nesërmen me datë 12.02.2026, me shoqërimin e fëmijës në klasë, nxënësit e tjerë u larguan nga klasa në mënyrë të udhëzuar, situatë e pandodhur më parë. Po atë ditë u prezantua një punonjëse e NJMF nr. 3, e cila i kërkoj ankueses të qëndronte në korridor. Biseda u zhvillua në prezencë të fëmijës dhe përfaqësuesve të SHPS, gjatë së cilës u bënë komente nënçmuese ndaj ankueses. Duke vërejtur gjendjen emocionale të rënduar të fëmijës, ankuesja kërkoj largimin e personave të pranishëm.*
27. *Me datë 13.02.2026, nxënësit e klasës u larguan nga ambienti i mësimi dhe u dërguan në bibliotekë, ndërsa fëmija mbeti i vetëm në klasë, duke krijuar një situatë izolimi dhe duke cenuar mundësinë për një proces të rregullt dhe përfshirës mësimor.*
28. *Në të njëjtën ditë, një person i prezantuar si drejtuese e këshillit të prindërve, në prezencë të disa personave (2 përfaqësues të këshillit të prindërve, 2 përfaqësues të SHPS, 1 prind klase dhe 1 mësuese ndihmëse), ndërhyri në prezencë të fëmijës duke ushtruar presion verbal*

lidhur me praninë e ankueses në klasë. Fëmija shfaq shenja të ngarkesës emocionale dhe kërkoj largimin e personave të pranishëm.

29. *Ekspozimi i një nxënësi me nevoja specifike zhvillimore përpara një grupi personash me tone presioni cenon parimin e mjedisit të sigurt arsimor dhe ka ndikuar negativisht në mirëqenien psiko-emocionale të fëmijës. Gjithashtu, gjatë kësaj situate, drejtuesja e këshillit të prindërve refuzoi të prezantohej dhe u shpreh me tone kërcënuese në prezencë të fëmijës, duke rënduar klimën emocionale.*
30. *Në përfundim, veprimet dhe mosveprimet e institucionit kanë sjellë trajtim të pabarabartë dhe përjashtues ndaj një nxënësi me aftësi të kufizuar, cenim të mjedisit të sigurt arsimor dhe ndërprerje të vijueshmërisë së procesit mësimor.*
31. *Nga sa më sipër rezulton se ndaj fëmijës tim, nxënës me nevoja specifike zhvillimore dhe me status të njohur zyrtarisht, është krijuar një trajtim i pabarabartë dhe përjashtues në mjedisin arsimor, i shoqëruar me situata izolimi, ndërhyrje të papërshtatshme në prezencë të tij dhe ushtrim presioni verbal ndaj kujdestares ligjore. Veprimet dhe mosveprimet e institucionit kanë sjellë cenim të mirëqenies psiko-emocionale të fëmijës, ndërprerje të vijueshmërisë arsimore dhe krijim të një mjedisi jo të sigurt pedagogjik.*

Në mënyrë të përsëritur, vendimmarrja institucionale nuk ka respektuar parimin e interesit më të lartë të fëmijës dhe as nevojat e tij individuale, duke çuar në izolim faktik nga grupi i klasës dhe trajtim që lidhet drejtpërdrejt me statusin e tij si fëmijë me aftësi të kufizuar dhe me rolin tim si kujdestare ligjore”.

Subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri konstatimin e diskriminimit institucional, të udhëzohet shkolla që të zbatojë masa të qarta arsimore për pranimin e kujdestarit ligjor dhe ndihmës personal në klasë si masë mbështetëse, ofrimin e një mjedisi të sigurt, gjithëpërfshirës dhe pa presion emocional dhe të ndalojë çdo praktikë që ka sjellë përjashtim faktik nga arsimi bazë, regjistrim të padrejtë të mungesave në sistemin SMIP, ose vlerësime jo objektive të nxënësit për shkak të ankesave apo të gjendjes së tij.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri

Në nenin 1 të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, përcaktohet se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Bazuar në nenin 32/1/a të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këto shkaqe.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32/2 dhe 33 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

- Me shkresën nr. 363/1, datë 25.02.2026, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka njoftuar dhe kërkuar parashtrime nga subjektet, lidhur me pretendimet e ankueses.

Me shkresën nr. 3502/1, datë 03.03.2026, ZVAP Tiranë, në mes të tjerash informoi Komisionerin se: “Nxënësi D.M., i regjistruar në klasën e VI për herë të parë në vitin shkollor 2025-2026, ka diagnozë “çrregullim i spektrit autik dhe prapambetje mendore e moderuar” dhe përfiton mësues ndihmës 12 orë/javë sipas rekomandimit të Komisionit Multidisiplinar. Në fillim të vitit, me kërkesë të prindit, u lejua përkohësisht prania e nënës, znj. M.D, në klasë. Kjo prani u zgjat më shumë se sa parashikohej dhe krijoi varësi emocionale te nxënësi, duke penguar zhvillimin e tij të pavarur.

Masat e institucionit: Shkolla emëroi mësuesen ndihmëse (tetor 2025), por prindi refuzoi pranimin e saj në klasë. Komisioni i AK-së vendosi afate 10-ditore e më pas 1-mujore për atashimin gradual të nxënësit me mësuesen ndihmëse. U ndryshua edhe klasa (nga VI-A në VI-B) me kërkesë të prindit. U hartua PEI (Plani Individual i Edukimit), por prindi nuk e firmosi. U ofrua mbështetje psikosociale e vazhdueshme, e penguar nga mungesa e bashkëpunimit të prindit.

Ndërhyrjet zyrtare: Në zbatim të shkresës së AKAP (11.12.2025), iu ndalua zyrtarisht znj. M.D qëndrimi në klasë gjatë orëve mësimore. GTN-ja (15.01.2026) u mblodh për vlerësimin e situatës, por prindi refuzoi pjesëmarrjen. Shkolla propozoi një Marrëveshje Bashkëpunimi (07.01–07.02.2026) për shkëputje graduale të prindit nga procesi mësimor, të cilën prindi refuzoi ta nënshkruajë.

Ankesa të palëve të treta: Prindërit e klasës VI-B (06.11.2025) dhe mësuesit (12.02.2026) parashtruan ankesa zyrtare kundër pranisë së vazhdueshme të nënës në klasë, duke theksuar ndikimin negativ në procesin mësimor.

Rekomandimi final i ZVAP Tiranë: Prindi të mos qëndrojë më në klasë; nxënësi të asistohet ekskluzivisht nga mësuesja ndihmëse. Më 18.02.2026, shkolla emëroi mësuesen A.D (e specializuar në pedagogji speciale) si mësuese ndihmëse të re për D.M.

Përfundimi i institucionit: Shkolla pohon se ka vepruar në përputhje të plotë me kuadrin ligjor për arsimin gjithëpërfshirës dhe interesin më të lartë të fëmijës, duke balancuar nevojat e nxënësit me ato të komunitetit shkollor, përballë mungesës së bashkëpunimit nga ana e prindit”.

Në zbatim të parimit të kontradiktoritetit e transparencës, për një gjykim sa më të drejtë të çështjes, ankuesja nëpërmjet e-mail-it datë 09.03.2026, është njohur me përgjigjen e ZVAP Tiranë.

Në kundërshtim të përgjigjes të ZVAP Tiranë, ankuesja me email-in datë 10.03.2026, në mes të tjerash ka informuar se: “Referuar pikës I: Vlerësimi i situatës së nxënësit.

Paraqitja e situatës së nxënësit D.M në këtë raport është e pjesshme dhe jo e saktë, pasi ajo nuk reflekton në mënyrë të plotë rrethanat reale në të cilat është zhvilluar procesi arsimor gjatë vitit shkollor 2025–2026 në shkollë.

Së pari, prania ime në ambientet e klasës është rekomanduar dhe nga mjekët specialist të fushës e pranuar nga vetë institucioni arsimor në fillim të vitit shkollor, për shkak të vështirësive të përshtatjes së nxënësit në një mjedis të ri shkollor. Në këto kushte, prania ime ka pasur për qëllim të lehtësojë procesin e adaptimit të fëmijës dhe të garantojë vijimësinë e procesit mësimor.

Së dyti, pretendimi se prania e prindit ka ndikuar negativisht në zhvillimin e pavarësisë emocionale të nxënësit nuk mbështetet në asnjë vlerësim profesional të dokumentuar nga specialistë të fushës së psikologjisë apo pedagogjisë speciale. Një konkluzion i tillë nuk mund të nxirret mbi bazën e vëzhgimeve subjektive të stafit administrativ apo pedagogjik, veçanërisht kur bëhet fjalë për një fëmijë me vështirësi zhvillimore, për të cilin çdo VKM apo ligji për arsim gjithëpërfshirës theksojnë rëndësinë e përshtatjes graduale dhe të mbështetjes nga strukturat gjatë procesit të përshtatjes në mjedisin shkollor.

Së treti, raporti nuk merr në konsideratë faktin se vështirësitë në përshtatjen e nxënësit kanë qenë të lidhura me situatat e tensionit të krijuara në ambientin shkollor dhe me ndërhyrjet e vazhdueshme administrative që kufizonin përshtatjen dhe akomodimin e nevojshëm për fëmijën.

Në këto rrethana, është e papranueshme që përgjegjësia për situatën t'i atribuohet pranisë sime si ndihmës personal/shoqërues, duke injoruar faktorët institucionalë që kanë ndikuar drejtpërdrejt në mirëqenien emocionale dhe integrimin e nxënësit në klasë.

Mënyra se si është paraqitur kjo situatë në këtë raport krijon një interpretim të njëanshëm të rrethanave dhe nuk reflekton parimet e arsimit gjithëpërfshirës, të cilat kërkojnë bashkëpunim real ndërmjet institucionit arsimor dhe prindit në funksion të interesit më të lartë të fëmijës.

Referuar pikës II. Masat e marra nga institucioni arsimor citon: “Miratimi i pranisë së prindit datë 12.09.2025 – Komisioni miraton shoqërimin e përkohshëm nga prindi. Unë nuk kam një dokument të tillë dhe nuk jam thirrur për të ma komunikuar”.

Në fillim të vitit kam kërkuar të ndjek fëmijën tim sepse u detyrova ti ndryshoja mjedis dhe duke njohur vështirësinë e fëmijës për t'u përshtatur kërkoja që të qëndroj pranë tij. Nuk është një favor i veçantë nga institucioni, por një zgjidhje e nevojshme për shkak të vështirësive të përshtatjes së një fëmije me vështirësi zhvillimore për stabilitetin emocional të fëmijës dhe për vijimësinë e procesit mësimor.

10.10.2025: Emërimi dhe prezantimi i mësueses ndihmëse erdhi pasi unë si prind reagova në email më datë 03.10.2025 për vështirësitë e fëmijës sepse shikoja që nuk kishin në qasje ndihmuese ndaj një fëmije me vështirësi motorike.

Citohet data 14.10.2025: Refuzimi nga prindi i pranisë së mësueses ndihmëse gjatë procesit mësimor.

Për një fëmijë me nevoja të veçanta, pranimi i një figure të re mbështetëse kërkon një proces gradual dhe të koordinuar, gjë që nuk rezulton të jetë planifikuar në mënyrë profesionale nga institucioni. Institucioni nuk shpjegon pse është refuzuar, në çfarë rrethanash, nëse ka pasur problem komunikimi? A është kërkuar një zgjidhje alternative? Pra mungon konteksti.

E shqetësuar nga veprimet e institucionit nis këtë sms më 14 tetor ku tregoj situatën. Ndër rreshta them: “kam frikë se më nxisin prindërit e fëmijëve për të më larguar nga aty”. Pra situata nuk ishte e qetë dhe miqësore por kishin nisur me ngacmime dhe agravime. Fëmija vinte nga një kontekst i ngjashëm në shkollën origjinë dhe tani po krijonin sërish të njëjtat situata për të bërë të mundur largimin e fëmijës.

Me 20.10.2025 dërgoj një email në postën elektronike të shkollës: Po atë ditë marr njoftim që mbledhja u shty një ditë pas: “Përshëndetje! Duke marrë parasysh ngarkesën tuaj, Komisioni i nxënësve me AK dhe drejtorja e shkollës ju ftojme që ditën e martë në orën 13.30 të jeni e pranishme në takimin e përbashkët. Faleminderit!”

Data 21.10.2025: Mbledhja e Komisionit të Zakonshëm të AK-së dhe vendosja e një afati 10-ditor për atashimin e nxënësit me mësuesen ndihmëse, rezultoi një komision i mbledhur për interesin më të lartë të mësueses ndihmëse dhe jo të fëmijës i cili po pësonte në mënyrë persistente një dhunë verbale me tone të larta ku i kërkohej të pranonte mësuesen ndihmëse dhe i thuhej që mami nuk është më mësuese. Një fëmijë me vështirësi zhvillimore që 5 vite kishte pasur prindin afër për shkak të vështirësisë, tani po përballej me një realitet tjetër ku stafit pretendonte që fëmija të kuptonte se nuk kishte më mamin në shkollë. Po këto mësuese që fëmijët e tyre me zhvillim tip i kishin aty në atë shkollë.

Afati 10-ditor për “atashimin” – Institucioni thotë: “u vendos një afat 10-ditor për atashimin e nxënësit me mësuesen ndihmëse”.

Në raste të fëmijëve me vështirësi zhvillimore adaptimi zakonisht kërkon proces gradual, jo afate të shkurtra administrative pa u konsultuar me mua, pavarësisht se jam palë thelbësore në procesin arsimor të fëmijës.

Renditja e një serie datash dhe vendimesh administrative nga institucioni arsimor nuk provon në vetvete se janë ndërmarrë masa efektive në interesin më të lartë të fëmijës. Një kronologji veprimesh formale administrative nuk mund të zëvendësojë detyrimin e institucionit për të garantuar një proces real dhe funksional të arsimit gjithëpërfshirës.

Duke parë sesi sjellja e stafit ndryshoi karshi meje dhe fëmijës, paraqes shqetësimin tim në email-in e datës 03.11.2025. Kjo ishte situata e krijuar dhe menaxhuar nga drejtuesja e shkollës. Pas këtij email situata vetëm agravo.

Referuar pikës III: Masat mbështetëse të ndërmarra nga institucioni arsimor.

Institucioni ka ofruar mbështetje të vazhdueshme përmes: sigurimit të mësueses ndihmëse; (thjeshtë në letër dhe jo për ndihmë por për të penguar në progresin e fëmijës me ndërhyrje pa takt duke iu

drejtuar me fjalët: “pusho”. Kjo ishte marrëdhënia që krijoi me fëmijën); përfshirjes së shërbimit psikosocial; (asnjëherë nuk ka luajtur rol qetësimi të situatës por me trup mbulonte derën që mos të futej fëmija në shkollë); ndryshimit të klasës (nga VI-A në VI-B), me kërkesë të prindit; (fëmija ka kaluar në klasën e 6-b ditën e dytë të shkollës sepse kishte më pak nxënës si klasë); bashkëpunimit me ZVAP, SPZ dhe PMF; (jo vetëm që nuk kishte bashkëpunim por kërkesat e mia binin në vesh të shurdhër dhe institucionet referuese përdorëshin për të presionuar. Fakt kallëzimi i bërë në polici ndaj punonjësës së NJMF, J.F e cila ishte përdorur dhe një vit më parë nga institucioni origjinë për të krijuar alibi për largimin nga puna; përcaktimit të afateve tranzitore për përshtatjen e nxënësit.

Fëmija nuk është abonim 10 ditor apo 1 muaj me afatet e institucionit që jo vetëm nuk tregon vullnet për të qetësuar situatën por nxit situata artificiale që sjellin dëm dhe ngarkesë emocionale tek fëmija. Raporti është i ndërtuar më shumë për të justifikuar veprimet administrative të institucionit, sesa për të bërë një analizë objektive të situatës së nxënësit, “masat” sipas tyre janë në fakt disa detyrime ligjore që ka shkolla ndaj nxënësit me nevoja, disa të tjera janë shkresa deklarative, pa prova konkrete.

Vlerësimi i masave mbështetëse të ndërmarra nuk mund të bazohet vetëm në numrin e veprimeve administrative, mbledhjeve apo shkresave të prodhuara gjatë një periudhe të caktuar. Efektiviteti i mbështetjes për një fëmijë me nevoja të veçanta duhet të matet mbi bazën e ndikimit real që këto masa kanë në mirëqenien emocionale, integrimin social dhe përparimin arsimor të nxënësit. Nëse pavarësisht këtyre veprimeve administrative situata e fëmijës ka vijuar të karakterizohet nga tensione në ambientin shkollor, vështirësi në ndjekjen e procesit mësimor dhe konflikte të vazhdueshme ndërmjet institucionit dhe prindit, atëherë këto masa nuk mund të konsiderohen si mbështetje efektive, por më tepër si veprime formale që nuk kanë arritur të përmbushin qëllimin e tyre në funksion të interesit më të lartë të fëmijës.

Referuar pikës IV: Plani Individual i Edukimit (PEI)

PEI është hartuar nga mësuesja ndihmëse dhe i është vënë në dispozicion prindit për shqyrtim dhe miratim. Deri më tani, plani nuk është firmosur dhe nuk janë paraqitur sugjerime të dokumentuara nga prindi.

Më datë 21.01.2025 psikologjia më vuri në dijeni një draft plan PEI i periudhës së dytë Janar-Mars për të cilin shpreha mosdakordësinë time me email datë 22.01.2026 dhe ndryshimet që duheshin në lidhje me vështirësinë e fëmijës. Reagimi im rezultoi një ndëshkim në notë ndaj fëmijës. Nota të tjetërsuara nga realiteti i fletoreve. Plani draft PEI është hartuar nga psikologjia M.P, mësuesja ndihmëse F.B (profil biologji) dhe mësuesja kujdestare A.H (profil gjeografi). Nuk u thirra në asnjë moment të diskutuara rreth planit PEI dhe nuk mu dha pas qëndrimeve të mia për ta firmosur.

Referuar pikës V. Mbështetja psikologjike

Thuhet se: “Nxënësi është ndjekur nga shërbimi psikosocial i shkollës, me fokus në uljen e ankthit të ndarjes, forcimin e pavarësisë emocionale dhe riintegrimin gradual në mjedisin shkollor. Këto ndërhyrje janë vështirësuar nga mungesa e bashkëpunimit të vazhdueshëm të prindit”.

SHPS ka detyra të mirëvendosura ku qëllimi kryesor është të përcaktojë rolin, detyrat dhe procedurat e punës së shërbimit psiko-social në shkollë, duke garantuar mbështetje për mirëqenien emocionale, sociale dhe arsimore të nxënësve sidomos atyre me nevoja specifike. Si prind me SHPS kam një komunikim në celular më 12.09.2025 në lidhje me bankën e fëmijës sepse krijonin situata ku fëmijës i zihej vendi me fjalë të mësueses kujdestare, ku bënin çmos të krijonin një problem. Mu kërkua gjithashtu certifikatë e gjendjes gjyqësore. Komunikimi në celular datë 21.10.2025 në lidhje me situatat që nisën të krijonin. Pa përgjigje, që fakton se zëri im si prind nuk dëgjohej.

Qëndrimet e punonjësve të shërbimit psiko-social, përfshirë veprimet ose mosveprimet e tyre kanë ndikuar negativisht në mirëqenien e fëmijës. Në fakt punonjësit e shërbimit psiko-social shkollor kanë rol të rëndësishëm, në promovimin dhe në mbështetjen, në suksesin akademik dhe social të nxënësve, duke ofruar shërbime në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe të tërthortë. Në rolin e ndërmjetësuesit dhe të lehtësuesit të marrëdhënieve, punonjësi i shërbimit psiko-social bashkëpunon me mësues (kujdestarë, lëndorë, ndihmës), me persona që ushtrojnë përgjegjësinë prindërore dhe me profesionistë të tjerë, për të krijuar një mjedis të sigurt në mbështetje të të mësuarit, duke ndikuar gjithashtu, në forcimin e lidhjes familje-shkollë-komunitet me nxënësin në qendër.

Referuar pikës VI: Frekuentimi

ZVA citon “Frekuentimi i nxënësit ka qenë i parregullt, kryesisht për shkak të refuzimit të hyrjes në shkollë pa praninë e prindit dhe shfaqjes së reagimeve emocionale të forta”.

Kur ZVA ka parë reagime emocionale të forta, pse e ka lejuar këtë situatë për 6 javë. Periudhë e parë dhe 3 javë periudhë e dytë? A është aty për akomodimin dhe përshtatjen e arsyeshme? Po si mund të lejohet një kolaps psikologjik i rëndë ku fëmija ekspozohet dhe diskretitohet para nxënësve, mësuesve dhe komunitetit? Po ashtu dhe prindi?

Në fakt frekuentimi i djalit ka qenë i rregullt deri sa është shoqëruar nga unë si prind. Me nxitjen e artificeve dhe agravimin e situatave nga ana e institucionit fëmija ka refuzuar qëndrimin pa praninë time. 6 javë pa mësim duke nisur nga data 10.11.2025 e deri më 19.12.2025 fëmija nuk është lejuar më të futet në institucion.

Referuar pikës VII: Marrëdhëniet me stafin pedagogjik

Marrëdhëniet e nxënësit me stafin pedagogjik kanë qenë korrekte dhe mbështetëse. Vështirësitë e hasura lidhen kryesisht me ndërhyrjet e vazhdueshme të prindit në procesin mësimor.

Si e fakton institucioni këtë?

Pra pasi e lënë 6 javë pa mësim me urdhra të njëanshëm nga institucioni, pasi e përflasin në sallën e mësuesve që një fëmijë me vështirësi nuk merr më shumë se 8-të dhe pse ai si nxënës ka treguar që ka punuar dhe është përgatitur çdo ditë me detyra dhe i rregullt në procesin mësimor. Dhe pse kthehet në mësim më datë 07.01.2026 dhe menjëherë nisin kërkesat për testim dhe vlerësim duke përfshirë në teste dhe tema për të cilat nuk i ka frekuentuar. Dhe pasi reagoj me email datë

13.01.2026 ku paraqes shqetësimin tim dhe kërkoj që çdo test të dakordësohet paraprakisht me mua si ndihmëse reale e nxënësit gjatë procesit mësimor, në ndërtim dhe formë të testit dhe të zhvillohet në kushte objektive dhe reale mësimore. E gjitha kjo interpretohet si ndërhyrje nga ana ime në procesin mësimor ?!

Referuar pikës VIII: Takimet me prindin

Janë zhvilluar takime të shumta me prindin, përfshirë takime me shërbimin psikosocial, drejtuesit e shkollës, Komisionin e AK-së, si dhe takimin e datës 07.01.2026 me përfaqësues të ZVAP Tiranë, ku u ra dakord për një afat shtesë njëmuor për atashimin e nxënësit me mësuesen ndihmëse.

Takimet e zhvilluara nuk kanë pasur karakter bashkëpunues apo mbështetës, por në shumë raste janë shoqëruar me presion të vazhdueshëm ndaj meje si prind, me qëllim që të mos qëndroja në ambientet e institucionit arsimor. Në vend që të ofrohej një dialog konstruktiv për të mbështetur integrimin e nxënësit në procesin mësimor, jam përballur me qëndrime kërcënuese dhe me përpjekje për të më larguar nga institucioni. Për këtë arsye, përshkrimi i këtyre takimeve në raport si proces bashkëpunimi nuk reflekton realisht mënyrën se si janë zhvilluar ato dhe nuk pasqyron klimën e presionit dhe tensionit që është krijuar gjatë tyre.

Referuar pikës IX. Zbatimi i shkresës së AKAP-it

Në raport thuhet se: “Në zbatim të shkresës së AKAP nr. 3003/1, datë 11.12.2025, u vendos moslejimi i znj. M.D për të qëndruar në ambientet e klasës gjatë orëve mësimore. Institucioni arsimor ka vepruar në përputhje me këtë shkresë”.

Megjithatë, kjo shkresë nuk më është bërë e ditur në momentin e nxjerrjes së saj dhe nuk më është komunikuar zyrtarisht, çka e bën këtë vendim një akt të njëanshëm, të marrë pa transparencë dhe pa përfshirjen time si palë e interesuar në këtë proces.

Gjithashtu, nga vetë përmbajtja e raportit rezulton se në takimin e zhvilluar më datë 07.01.2026 me përfaqësues të ZVAP Tiranë është rënë dakord për një afat shtesë njëmuor për përshtatjen e nxënësit. Në praktikë, kjo marrëveshje bie në kundërshtim me vendimin e mëparshëm për moslejimin tim në ambientet e institucionit, duke treguar se vetë institucionet e kanë tejkaluar ose modifikuar atë urdhër. Kjo situatë tregon se vendimet e marra kanë qenë të njëanshme dhe jo të bazuara në një vlerësim të plotë dhe objektiv të situatës së nxënësit dhe të nevojave të tij reale për përshtatje në mjedisin shkollor.

Po ashtu, duhet theksuar se përfshirja e ZVAP Tiranë në këtë proces ngre shqetësime serioze për konflikt interesi, pasi unë kam qenë më parë në marrëdhënie pune me këtë institucion dhe jam larguar nga puna në mënyrë të padrejtë. Ky fakt krijon dyshime të arsyeshme mbi paanshmërinë e vlerësimeve dhe vendimeve të marra gjatë trajtimit të kësaj çështjeje.

Referuar pikës X. Grupi Teknik Ndërdisciplinor (GTN)

Me 15.01.2026, me kërkesë të shkollës, u zhvillua mbledhja e GTN-së. Prindi u ftua, por refuzoi pjesëmarrjen. Takimi u realizua për vlerësimin e situatës dhe koordinimin e ndërhyrjeve të mëtejshme.

Më datë 05.01.2026 jam paraqitur në zyrën e znj. J.F punonjëse NJMF për të referuar situatën e vështirë të krijuar nga veprimet e shkollës, të cilat po pengonin arsimimin e fëmijës tim pa akomoduar kërkesat individuale për shkak të vështirësive psiko-motore që ai ka. Znj. J.F e nisi bisedën me tone të larta duke pranuar se më kishte kërcënuar me sms në telefon sepse nuk i isha përgjigjur telefonatës së saj. Si pasojë e tensionit të krijuar në zyrën e saj fëmija reagoi me shqetësim të fortë emocional dhe fizik, duke përplasur duart në tavolinën e saj. Në këto rrethana, u detyrova të largohem nga zyra e saj, pasi situata e krijuar nga kjo punonjëse i shkaktoi stres emocional fëmijës tim. Më datë 13.01.2025 znj. J.F ka paralajmëruar dhe iniciuar ngritjen e GTN, jo për shkak të rrezikut real për fëmijën por pas reagimeve të mia zyrtare kundër veprimeve të paligjshme të institucioneve që koordinonin veprimet ndërmjet tyre.

Referuar Pikës XI – “Marrëveshja e bashkëpunimit me prindin”

Në raport thuhet se drejtoria e Shkollës “Niket Dardani” ka hartuar një “Marrëveshje Bashkëpunimi dhe Angazhimi” me prindin e nxënësit, e cila parashikonte kushte dhe kufizime për praninë e prindit në ambientet e klasës për një periudhë njëmuajore. Pretendohet gjithashtu se kjo marrëveshje nuk është nënshkruar nga prindi, duke pamundësuar zbatimin e mekanizmit të bashkëpunimit.

Ky interpretim nuk pasqyron realitetin dhe kërkon sqarimet e mëposhtme: - E drejta për arsim nuk mund të kushtëzohet me marrëveshje të përkohshme; - Marrëveshja ishte e njëanshme dhe subjektive e prishej nga institucioni kur të donte ai, si dhe rezultoi në fakt më datë 10.02.2026.

Referuar pikës XII. Ankesat e prindërve dhe shqetësimet e komunitetit shkollor

Në raport pretendohet se më datë 06.11.2025 prindër të nxënësve të klasës VI-B kanë paraqitur një kërkesë/ankesë lidhur me praninë time në klasë, ndërsa më datë 12.02.2026 një grup mësuesish i janë drejtuar ZVAP Tiranë me shqetësime për ndërhyrje të prindit gjatë procesit mësimor.

Megjithatë, këto pretendime nuk janë shoqëruar asnjëherë me vënien në dispozicion të dokumenteve përkatëse, duke më mohuar të drejtën për t'u njohur me përmbajtjen konkrete të këtyre ankesave dhe për të dhënë qëndrimin tim mbi to. Nga kronologjia e ngjarjeve rezulton se çdo reagim apo ankesë e imja ndaj veprimeve të institucionit është ndjekur menjëherë nga organizimi i ankesave kolektive.

Konkretisht:

- me 03.11.2025 kam paraqitur një email zyrtar ku kam ngritur shqetësime për trajtimin e fëmijës tim në procesin mësimor*
- me 06.11.2025 pretendohet se është paraqitur një ankesë nga disa prindër*

- me 10.02.2026 kam paraqitur një ankesë në email për vlerësimet ndëshkuese të mësueseve ndaj fëmijës tim
- me 12.02.2026 një grup mësuesish i drejtohen ZVAP Tiranë me një kërkesë tjetër kundër pranisë sime në klasë.

Kjo përputhje kohore krijon dyshime të arsyeshme se këto ankesa janë përdorur si instrument presioni institucional ndaj meje si prind që ka ngritur shqetësime për respektimin e të drejtave të fëmijës së tij. Referimi i vazhdueshëm i këtyre ankesave në dokumentet zyrtare ka krijuar një situatë ku prania e ime dhe nevojat mbështetëse të fëmijës paraqiten si problem për komunitetin shkollor. Përdorimi i ankesave kolektive si argument për kufizimin e pranisë së prindit dhe për vënien në diskutim të aksesit të fëmijës në procesin mësimor përbën një formë diskriminimi indirekt ndaj një nxënësi me aftësi të kufizuara.

Referuar Pikës XI – Përfundime

Në përfundimet e raportit pretendohet se institucioni arsimor ka përmbushur detyrimet ligjore dhe administrative dhe se situata është krijuar si pasojë e komunikimeve dhe ankesave të përsëritura nga ana e prindit. Ky konkluzion nuk mbështetet në analizë objektive të fakteve dhe nuk pasqyron realitetin e situatës së krijuar.

1. Interesi më i lartë i fëmijës nuk është garantuar në praktikë

Megjithëse në raport pretendohet se janë marrë masa në interesin më të lartë të fëmijës, nga vetë kronologjia e ngjarjeve rezulton se fëmija është përballur me pengesa të vazhdueshme për të ndjekur procesin mësimor, janë vendosur kufizime administrative ndaj pranisë mbështetëse të prindit dhe është krijuar një situatë tensioni institucional që ka ndikuar drejtpërdrejt në gjendjen emocionale dhe arsimore të nxënësit. Në këto kushte, nuk mund të konsiderohet se interesi më i lartë i fëmijës është mbrojtur në mënyrë efektive.

2. Reagimet e prindit nuk përbëjnë problem administrativ

Raporti paraqet komunikimet dhe ankesat e mia si një “ngarkesë administrative” për institucionin. Megjithatë, reagimet e mia kanë qenë ushtrim i një të drejte ligjore dhe prindërore për të kërkuar respektimin e të drejtës së fëmijës për arsim dhe për trajtim të përshtatshëm në një institucion publik. Paraqitja e këtyre reagimeve si problem administrativ krijon një perceptim të gabuar, sikur mbrojtja e të drejtave të një fëmije me aftësi të kufizuara përbën një shqetësim për institucionin.

3. Përdorimi i ankesave kolektive nuk zëvendëson detyrimet ligjore

Referimi i vazhdueshëm në raport ndaj ankesave të prindërve të klasës apo të mësuesve nuk mund të justifikojë kufizimin e të drejtave të një nxënësi me nevoja të veçanta. Detyrimi i institucionit arsimor publik është të garantojë arsim gjithëpërfshirës dhe përshtatje të arsyeshme për çdo nxënë, pavarësisht perceptimeve apo shqetësimeve të pjesëve të tjera të komunitetit shkollor që sërish nuk janë të faktuara dhe të njëanshme.

4. Pretendimi për administrim profesional të situatës është absurd

Nga faktet e paraqitura rezulton se situata është karakterizuar nga vendime të njëanshme administrative, mungesë transparence në komunikimin e dokumenteve dhe ankesave, përjashtimin tim nga proceset e rëndësishme vendimmarrëse arsimore dhe krijim i një klime tensioni në ambientin shkollor ku drejtuesja M.K më drejtohet me fjalët: “Ke shumë pretendime çfarë ke ndërmend të bësh djalin”; “Nuk ke respekt për veten dhe kërkon të kenë të tjerët”; “Kush je ti që më prish imazhin e shkollës, do e çoj deri në fund këtë punë”; “më njeh mua kush jam, pyet për mua kur e regjistrove fëmijën këtu”.

- *Kur nëndrejtuesha shprehet para fëmijës dhe shokëve të tij me tone të papranueshme për një mjedis arsimor me fjalët: “zër një cep aty në fund dhe mbyll gojën, ose mere djalin e çoje në shkollë private”.*
- *Ku SHPS i kthehet fëmijës me fjalët: “do qash mirë kur të dalësh nga institucioni”; “vlerësimi ulet në 50 % se ke qëndruar pranë fëmijës”.*
- *Ku mësuesja ndihmëse ushtronte presion që ti vështirësohet puna fëmijës pasi djali me të nuk ndërvepronte, por më mohoj dhe mua mundësia për ta ndihmuar dhe orientuar gjatë testimit.*
- *Mësuesja kujdestare organizon nxënësit e klasës që me hyrjen në klasë të djalit, të gjithë të dilnin nga klasa dhe të futeshin në bibliotekë. Mësuesja ja bënte me kokë. Veprime që i kam parë vetë.*
- *Mësueset që në mënyrë të udhëzuar ulën vlerësimin e fëmijës.*

Në këto kushte, pretendimi se situata është administruar në mënyrë profesionale dhe në përputhje të plotë me kuadrin ligjor nuk gjen mbështetje në faktet konkrete të çështjes.

5. Balanca midis interesave të komunitetit nuk mund të cenojë të drejtën për arsim

Pretendimi se drejtori i institucionit ka ruajtur një “balancë të arsyeshme” midis interesit të fëmijës dhe interesave të komunitetit shkollor nuk mund të justifikojë masa që në praktikë kufizojnë ose pengojnë aksesin e një nxënësi me aftësi të kufizuara në procesin arsimor.

Përfshirja e një sërë aktorësh institucional si NJMF, policia e shtetit, drejtuesja e këshillit të prindërve, prindër të klasës së djalit, nxënës, mësues, ZVAP, AKAP, fakton diskriminim të një fëmije me 3 diagnoza që duhej medoemos të largohej nga shkolla.

Referuar pikës XIII. Rekomandimi i Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar

Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar Tiranë udhëzoi drejtuesin e institucionit arsimor që: prindi znj. M.D të mos qëndrojë në ambientet e klasës gjatë zhvillimit të procesit mësimor; nxënësi D.M. të asistohet nga mësuesja ndihmëse, në përputhje me rekomandimet e Komisionit Multidisiplinar dhe kuadrin ligjor në fuqi për arsimin gjithëpërfshirës.

Pra ZVA e cila është në konflikt dhe palë ndërgjygjëse me mua merr vendime në lidhje me vijueshmërinë arsimore të fëmijës tim dhe pse vetë znj. Ermira Milori me 07.01.2026 shikon dhe asiston nga afër ngarkesën emocionale të shkaktuar fëmijës. Po vetë drejtuesja e ZVA më datë 11.02.2026 me thërret në zyrën e saj dhe më kërkon ta lëviz fëmijën në një shkollë tjetër e gjitha kjo sepse kisha kërkuar kopje të testeve të fëmijës dhe argumentim të notës me gojë në email data

10.02.2026. Të nesërmen e takimit me drejtuesen e ZVA fëmijët dolën nga klasa dhe djali u la vetëm. Po atë ditë qenka nxitur dhe peticioni i mësueseve datë 12.02.2026.

Në raport përmenden disa dokumente dhe vendimmarrje që pretendohet se kanë orientuar veprimet e institucionit arsimor, ndërkohë që për shumicën e tyre unë nuk kam pasur dijeni dhe nuk jam përfshirë në procesin e diskutimit apo vendimmarrjes, pavarësisht se ato lidhen drejtpërdrejt me arsimimin dhe mirëqenien e fëmijës tim.

Konkretisht, nuk më janë komunikuar dhe nuk kam dijeni për dokumentet e mëposhtme: shkresa e ZVAP Tiranë për rekomandimet e KMD, datë 08.10.2025; plani individual 10-ditor, datë 21.10.2025; kërkesa/ankesa e prindërve të klasës VI-B, datë 06.11.2025; shkresa e Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar, datë 11.12.2025; peticioni i Këshillit të Prindërve, datë 02.12.2025; peticioni i Këshillit të Mësuesve, datë 12.02.2026.

I vetmi dokument për të cilin kam pasur dijeni është marrëveshja e bashkëpunimit dhe angazhimit e datës 07.01.2026 të cilën e prishën sipas dëshirës.

Mungesa e komunikimit të këtyre dokumenteve përbën një problem serioz procedural, pasi si prind jam palë e drejtpërdrejtë në procesin arsimor dhe vendimet që lidhen me fëmijën nuk mund të merren në mënyrë të njëanshme, pa transparencë dhe pa mundësinë për t'u informuar apo për të dhënë qëndrimin përkatës.

Në këto kushte, vendimmarrjet e marra mbi bazën e dokumenteve që nuk më janë bërë të ditura dhe për të cilat nuk jam konsultuar, nuk mund të konsiderohen si rezultat i një procesi gjithëpërfshirës dhe transparent në interesin më të lartë të fëmijës.

Nga sa u paraqit më sipër rezulton se veprimet dhe mosveprimet e ndërmarra nga Shkolla dhe strukturat e përfshira në këtë proces kanë krijuar një situatë që ka penguar ushtrimin efektiv të së drejtës së fëmijës për arsimim në kushte të barabarta dhe gjithëpërfshirëse. Mungesa e zbatimit të përshtatjeve të arsyeshme, kufizimi i rolit të kujdestarit ligjor në procesin arsimor, moskomunikimi i dokumenteve dhe vendimeve që lidhen drejtpërdrejt me fëmijën, si dhe krijimi i pengesave në vijueshmërinë e procesit mësimor kanë çuar në një trajtim të pabarabartë dhe përjashtues të nxënësit”.

Me shkresën nr. 121, datë 10.03.2026, Shkolla “Niket Dardani”, në mes të tjerash informoi Komisionerin se: “Nxënësi D.D është nxënës i klasës VI pranë shkollës “Niket Dardani”, i regjistruar për herë të parë në muajin shtator të vitit shkollor 2025-2026, me diagnozë “Çrregullim i spektrit autik dhe prapambetje mendore e moderuar”.

Institucioni ynë arsimor aktualisht ka 19 nxënës me aftësi të kufizuara, për të cilët ofrohet mbështetje sipas legjislacionit në fuqi dhe parimeve të arsimit gjithëpërfshirës.

Në muajin qershor 2025 në zbatim të legjislacionit dhe rregullores së arsimit parauniversitar, nxënësi me AK paraqitet pranë ZVAP Tiranë për realizimin e vlerësimit multidisiplinar.

Me datë 12.09.2025 në ambientet e shkollës u mbledh komisioni i AK i cili në mungesë të mësueses ndihmëse vendosi që prindi të shoqërojë nxënësin në mjediset e shkollës deri në ardhjen e rekomandimit nga ZVAP Tiranë, me qëllim garantimin e mbështetjes dhe vazhdimësinë e procesit mësimor për nxënësin.

Me datë 08.10.2025 në shkollë vjen rekomandimi nga ZVAP për ndarjen e orëve të mbështetjes mësimore të nxënësve me AK, sipas të cilit nxënësi D.D përfiton 12 orë/javë mbështetje nga mësuese mbështetëse.

Me datë 10.10.2025 vjen nga ZVAP, mësuese ndihmëse, në bazë të vlerësimit aty për aty e cila ka filluar ofrimin e mbështetjes së fëmijës pas prezantimit me prindin, në bazë të rekomandimit për orët mësimore dhe për mbështetjen emocionale të nxënësit në mjediset e shkollës.

Në përputhje me legjislacionin në fuqi për arsimin parauniversitar, prindi ka shoqëruar fëmijën në ambientet e shkollës nga data 08.09.2025 deri me 10.10.2025, moment në të cilin është paraqitur mësuesja ndihmëse. Menjëherë pas prezantimit me mësuesen ndihmëse, znj. M.D, prindi, ka refuzuar praninë e mësueses ndihmëse. Për shkak të vështirësive të hasura me prindin, e cila në mënyrë të vazhdueshme ka nxitur edhe fëmijën që të mos pranonte mësuesen ndihmëse, shkolla u detyrua të organizojë një takim institucional, ku ishin të pranishëm 9 përfaqësues të stafit të shkollës, si dhe znj. M.D. Në këtë takim u vendos që prindi të qëndronte për një periudhë 10-ditore, me qëllim mundësimin e atashimit gradual të fëmijës me mësuesen ndihmëse.

Gjatë kësaj periudhe, prindi jo vetëm që nuk kontribuoi pozitivisht në procesin e përshtatjes së fëmijës, por shkaktoi problematika të vazhdueshme në shkollë, duke njoftuar Policinë e Shtetit për të ashtuquajturën “dhunë psikologjike”, në një rast kur psikologia e shkollës kishte kërkuar dorëzimin e telefonit celular. Kjo është një procedurë e ndjekur që nga dita e parë e shkollës dhe për të cilën prindi ka firmosur procesverbal, ku angazhohet për dorëzimin e pajisjes çdo ditë pranë Zyrës së Shërbimit Psiko-Social.

Me datë 06.11.2025 u zhvillua një takim në ambientet e shkollës, me praninë e SPZ-së së zonës, punonjësës së NJMF-Njësia 3, përfaqësuesve të ZVAP Tiranë, si dhe organizmave të shkollës, si drejtoria, komisioni i zakonshëm i AK për shkollën, përgjegjës së kurrikulës së arsimit special, mësuese kujdestare, prindi ftohet të marrë pjesë por refuzon në mënyrë kategorike bashkëpunimin. U morën në shqyrtim të gjitha problematikat e shkaktuara nga prindi në mjediset e klasës, si dhe në marrëdhënien me komunitetin e prindërve të klasës së VI-B, (peticioni drejtuar shkollës dhe instancave të larta arsimore) kërcënimeve të dërguara mësuesve në telefon.

Pas diskutimeve me përgjegjësi të problematikave të krijuara e situatës së mjedisit të të nxënësit, u vendos që prindi të mos lejohej të qëndronte në ambientet e brendshme të shkollës. Njoftim i cili i është bërë e ditur prindit në sistemin SMIP edhe verbalisht. Prindi ka shpërfillur kërkesën e shkollës duke krijuar situata jo korrekte në mjediset e shkollës, denigrim të mësueses ndihmëse, qëndrime bullizuese në klasë me nxënësit, marrëdhënie kontradiktore me komunitetin, mungesë absolute për bashkëpunim me shkollën.

Me datë 11.12.2025, në shkollë ka ardhur vendimi i Agjencisë Kombëtare të Arsimit Parauniversitar (AKAP), pas një peticioni të prindërve të klasës VI-B drejtuar Ministrit të Arsimit, ku citohet si vijon, drejtoria e shkollës duhet të: “Mos lejojë znj. M.D të qëndrojë në mjediset e klasës gjatë orëve të mësimi. Nxënësi duhet të vijojë të asistohet në klasë vetëm nga mësuesja ndihmëse në bashkëpunim me mësuesit lëndor”.

Pas insistimit të vazhdueshëm të prindit, me datë 07.01.2026, ZVAP sugjeroi mbështetjen e znj. M.D, dhënien e një afati 1-mujor, në interesin më të lartë të fëmijës, me qëllim atashimin e nxënësit me shkollën. Gjatë kësaj periudhe njëmuajore qëndrimi, prindi jo vetëm që nuk ndikoi pozitivisht në procesin e integritetit të fëmijës, por përkundrazi, ndikoi negativisht duke cenuar orën mësimore, duke intimiduar nxënësit, si dhe duke kontrolluar çantat e fëmijëve. Për pasojë, nxënësit e klasës nuk pranonin të qëndronin më në klasë në praninë e prindit.

– Lidhur me Planin Edukativ Individual (PEI).

PEI është dokument zyrtar që administrohet nga stafi i institucionit arsimor në funksion të interesit më të mirë të fëmijës. PEI hartohet në bashkëpunim ndërmjet psikologut, mësuesit ndihmës, mësuesve lëndorë dhe prindit.

Në rastin konkret, prindi nuk ka pranuar të bashkëpunojë në hartimin e PEI-t, por ka paraqitur një dokument të hartuar vetëm nga vetë prindi, i cili nuk është në përputhje me udhëzimet e ASCAP dhe Ministrit të Arsimit. Prindit i është kërkuar në mënyrë të përsëritur të zhvillohen takime për diskutimin dhe hartimin e përbashkët të PEI-t, por ka refuzuar, duke u paraqitur në zyrën e SHPS, gjithmonë i shoqëruar nga fëmija.

PEI është hartuar nga mësuesi ndihmës, psikologu dhe mësuesit lëndorë dhe i është dorëzuar prindit një kopje për të paraqitur sugjerimet e tij. Pas disa ditësh, prindi e ka rikthyer dokumentin me shënime, duke shprehur se nuk do ta firmosë.

Komisioni i Aftësisë së Kufizuar në shkollë, duke u mbështetur në Udhëzuesin për praktikën e punës së Shërbimit Psiko-Social Shkollor (rishikuar qershor 2025), kapitulli: Planifikimi dhe ofrimi i shërbimit për aftësinë e kufizuar, pika C, ku përcaktohet se: “Në rastet kur prindi nuk është dakord me përmbajtjen e PEI-it, komisioni shqyrton pretendimet e prindit, bën ndryshimet e nevojshme dhe plani konsiderohet i miratuar”.

Në këtë mënyrë është vepruar për dy periudha radhazi për PEI-n e nxënësin.

Për sa i përket vlerësimit me nota të nxënësit, mësuesit nuk kanë arritur asnjëherë ta vlerësojnë në mënyrë të pavarur. Kjo pasi detyrat e shtëpisë, ushtrimet në klasë, si edhe testimet, janë realizuar vazhdimisht me ndërhyrjen e drejtpërdrejtë të prindit. Edhe në rastet kur nxënësi është ngritur në tabelë, prindi ka qëndruar pranë duke e udhëzuar gjatë zgjidhjes së detyrës.

Duke qenë nxënës me AK, mësuesit janë përpjekur ta motivojnë dhe ta inkurajojnë për përfshirjen në procesin mësimor, duke i vlerësuar përpjekjet në detyrat e realizuara. Megjithatë, këto vlerësime kanë pasur karakter motivues dhe nuk përbëjnë një vlerësim real të njohurive të nxënësit, pasi ai nuk është lejuar nga prindi të realizojë detyra apo teste në mënyrë të pavarur.

Në këto kushte, mësuesit nuk kanë pasur mundësi të bëjnë një vlerësim objektiv të nivelit real të njohurive dhe aftësive të nxënësit.

Sa i përket pretendimit për ndërprerje të procesit mësimor, sqarojmë se shkolla nuk i ka mohuar asnjëherë nxënësit të drejtën për ndjekjen e mësimi. Kufizimi i hyrjes së prindit në ambientet e klasës është bërë në përputhje me rregulloren e brendshme të institucionit dhe normat e sigurisë, me qëllim garantimin e një klime të qetë dhe funksionale për të gjithë nxënësit. Prania e vazhdueshme e prindit gjatë procesit mësimor nuk parashikohet nga legjislacioni në fuqi dhe cenon zhvillimin normal të orës mësimore.

Duke u bazuar në problematikën e vazhdueshme me të cilën po përballlet institucioni, kërkojmë mbështetjen e institucioneve përgjegjëse, pasi znj. M.D po ushtron forma të dhunës psikologjike ndaj fëmijës duke përdorur manipulim të theksuar emocional, pengim i vazhdueshëm i procesit mësimor dhe po i mohon atij të drejtën për t'u arsimuar në një mjedis të sigurt dhe të përshtatshëm.

Kjo sjellje ka ndikuar rëndë në mirëqenien dhe zhvillimin efëmijës, duke krijuar një atmosferë të pasigurisë dhe ankthit në mjedisin arsimor. E drejta efëmijës për një arsimim të sigurt dhe të barabartë është shkelur në mënyrë të përsëritur dhe kërkojmë veprime urgjente për të adresuar këtë çështje. Kjo sjellje ka ndikuar drejtpërdrejt në klimën/mjedisin e të nxënës në klasë, vështirësi në mësimdhënie, cenim të të drejtave për arsimim të nxënësve të tjerë, mjedis të sigurt, e të nxënës efektiv”.

Në zbatim të parimit të kontradiktoritetit e transparencës, për një gjykim sa më të drejtë të çështjes, ankuesja nëpërmjet e-mail-it datë 10.03.2026, është njohur me përgjigjen e shkollës.

Në kundërshtim të përgjigjes të shkollës, ankuesja me email-in datë 10.03.2026, në mes të tjerash ka informuar se: “Lidhur me deklarin e institucionit se në shkollë janë 19 nxënës me aftësi të kufizuara.

Si prind shoqërues i fëmijës tim, i cili ka qenë i pranishëm në ambientet e shkollës për një periudhë të konsiderueshme kohe, kam pasur mundësinë të vëzhgoj nga afër mënyrën e trajtimit të nxënësve të tjerë me aftësi të kufizuara. Në këtë periudhë kam parë prindër apo terapistë që shoqëronin fëmijët e tyre por për ta procesi mësimor zhvillohej pa tensione apo ndërhyrje të përsëritura nga stafi drejtues siç veprime me mua. Ndaj fëmijës tim është ushtruar një qasje krejtësisht tjetër, e karakterizuar nga ndërhyrje të shpeshta në klasë, thirrje të vazhdueshme në drejtori dhe presion për pranimin e menjëhershëm të një figure të re mbështetëse, pa marrë në konsideratë reagimin emocional të fëmijës. Situatë e pasqyruar në email datë 03.11.2025.

Vlen të theksohet se përshkallëzimi i tensionit në raport me mua dhe fëmijën tim filloi pas vendosjes së mësueses ndihmëse kur stafi drejtues kuptoi se kërkesa ime për të kaluar si mësuese ndihmëse i fëmijës tim nuk u pranua dhe u informua për statusin tim profesional si mësuese e larguar nga sistemi arsimor. Pas këtij momenti, komunikimi dhe qasja e institucionit ndryshuan ndjeshëm, duke kaluar në një komunikim të tensionuar dhe konfliktual.

Fakti që institucioni ka në përbërje edhe nxënës të tjerë me aftësi të kufizuara nuk përbën në vetvete provë se parimet e arsimit gjithëpërfshirës janë zbatuar në mënyrë të barabartë në çdo rast. Përkundrazi, mjafton të merren pamjet filmike në ambientet e shkollës dhe faktohet se trajtimi ndaj fëmijës tim ka qenë i ndryshëm nga trajtimi ndaj nxënësve të tjerë në situata të ngjashme. Kjo situatë ngre dyshime serioze mbi barazinë e trajtimit dhe mbi respektimin e parimeve të arsimit gjithëpërfshirës, të cilat kërkojnë që çdo nxënës me aftësi të kufizuara të trajtohet me të njëjtin standard mbështetjeje dhe respekti institucional.

Në lidhje me pretendimet e paraqitura nga institucioni arsimor lidhur me situatën e krijuar pas vendosjes së mësueses ndihmëse në datën 10.10.2025, sqaroj sa vijon:

Së pari, paraqitja e situatës si një refuzim i thjeshtë i prindit ndaj pranisë së mësueses ndihmëse nuk pasqyron realitetin në institucion. Qëndrimi im ka qenë shqetësim i arsyeshëm për ndikimin emocional që ndërhyrja e menjëhershme e një figure të re mbështetëse, pati tek djali. Fëmija reagoi me ankth, refuzim për tu ndarë nga unë dhe shfaqti shqetësim emocional pas ndërhyrjeve imponuese të personelit, duke e ekspozuar dhe vendosur në situata diskriminimi për shkak të aftësisë së kufizuar, situata të cilat janë komunikuar në mënyrë të përsëritur dhe zyrtare drejt institucionit arsimor në email 03.11.2025 e në vijim.

Së dyti, pretendimi se prindi ka nxitur fëmijën të mos pranojë mësuesen ndihmëse është një interpretim subjektiv që nuk mbështetet në prova objektive. Fëmijët me vështirësi zhvillimore shpesh reagojnë me rezistencë ndaj ndryshimeve të papritura në figurat mbështetëse dhe në rutinën e tyre të përditshme. Ky është një fenomen i njohur në psiko-pedagogji dhe nuk mund të më atribuohet mua. Mungesa e akomodimit të arsyeshëm të nevojave të tij fakton se nuk respektohej interesi më i lartë i fëmijës përkundrazi u bë viktimë e stafit drejtues dhe SHPS të cilët ushtronin presion në prezencë të personelit dhe shokëve që fëmija të pranonte me doemos mësuesen ndihmëse.

Së treti, komunikimet e mia me institucionin arsimor kanë qenë të orientuara drejt bashkëpunimit dhe gjetjes së një zgjidhjeje që të garantonte stabilitetin emocional të fëmijës. Në asnjë moment nuk kam kundërshtuar parimin e mbështetjes arsimore për nxënësit me nevoja të veçanta, por kam kërkuar që procesi i përshtatjes të realizohej gradualisht dhe në përputhje me gjendjen emocionale të fëmijës.

Së katërti, pretendimi se ndërhyrja e Policisë së Shtetit ka qenë e pajustificuar nuk qëndron. Ndërhyrja është kërkuar në një situatë tensioni të krijuar në ambientet e shkollës nga ndërhyrjet e përsëritura të përfaqësuesve të Shërbimit Psiko-Social, të cilët paraqiteshin çdo ditë në klasë duke ushtruar presion që fëmija të pranonte menjëherë praninë e mësueses ndihmëse. Këto ndërhyrje janë kryer në prezencë të nxënësve të tjerë dhe shpesh me tone autoritare, duke e ekspozuar fëmijën përpara bashkëmoshatarëve dhe mësuesve.

Për këtë arsye, ndërhyrja e Policisë së Shtetit është kërkuar për të dokumentuar situatën dhe për të shmangur përshkallëzimin e konfliktit në ambientet e shkollës. Ky veprim përbën një mjet ligjor

të përdorur nga unë si prind për të mbrojtur interesin dhe mirëqenien e fëmijës tim dhe nuk mund të interpretohet si sjellje problematike.

Gjithashtu, gjatë kësaj periudhe drejtuesja e institucionit më ka komunikuar në mënyrë të përsëritur mundësinë e “lëvizjes paralele” të fëmijës në një shkollë tjetër, për shkak se ai shfaqte vështirësi për të qëndruar në klasë pa praninë time si prind shoqërues. Ky fakt provohet edhe nga komunikimet elektronike të zhvilluara në atë periudhë, ku referohet në mënyrë të drejtpërdrejtë ideja e largimit të fëmijës nga shkolla përmes lëvizjes paralele. Këto komunikime tregojnë se, në vend që institucioni të përqendrohej në mbështetjen e fëmijës dhe në krijimin e kushteve për përshtatjen e tij në klasë, është ushtruar presion për ta larguar atë nga institucioni arsimor.

Lidhur me pretendimin e institucionit për takimin e datës 06.11.2025 dhe vendimin për të mos lejuar praninë time në ambientet e brendshme të shkollës, sqaroj se paraqitja e situatës në këtë mënyrë nuk pasqyron realitetin e plotë të marrëdhënies mes meje si prind dhe institucionit arsimor.

Siç kam shpjeguar edhe në komunikimin tim zyrtar drejtuar shkollës, gjatë gjithë periudhës në fjalë kam qenë në komunikim të vazhdueshëm me institucionin dhe kam qenë fizikisht e pranishme në ambientet e shkollës për të mbështetur fëmijën tim në procesin e integritimit në klasë, në përputhje me nevojat e tij zhvillimore dhe rekomandimet për mbështetje individuale. Prania ime në klasë nuk ka qenë në cilësinë e një prindi vëzhgues, por në funksion të mbështetjes së fëmijës në momentet kur ai has vështirësi në komunikim, përqendrim dhe vetërregullim emocional.

Siç kam përshkruar edhe në email-in tim, në asnjë rast nuk kam ndërhyrë në procesin mësimor apo në detyrat e stafit pedagogjik. Përkundrazi, prania ime ka pasur qëllim ruajtjen e qetësisë së fëmijës dhe parandalimin e situatave të stresit që janë shfaqur pasi ndryshuan qasje me fëmijën.

Në këto kushte, vendimi i marrë në mungesën time, për të ndaluar praninë time në ambientet e brendshme të shkollës përbën një masë të njëanshme që prek drejtpërdrejt procesin e përshtatjes së fëmijës në mjedisin shkollor. Kjo është veçanërisht problematike duke pasur parasysh se më parë vetë institucioni kishte pranuar nevojën për një periudhë adaptimi ku prindi të ishte i pranishëm në klasë për të mbështetur integrimin e fëmijës në procesin mësimor.

Kështu që, pretendimet e ngritura nga institucioni për sjellje denigruese, bullizuese apo për mungesë bashkëpunimi nga ana ime vijnë pas reagimit tim me email datë 03.11.2026. Si pasojë e qëndrimit të mbajtur, nisën të ndërtonin në mënyrë të papërgjegjshme një narrative të gënjeshtërt e cila nuk shoqërohet me përshkrim të episodeve konkrete apo prova që t'i mbështesin ato. Në mungesë të elementeve të verifikueshme, këto pretendime nuk mund të konsiderohen bazë për të justifikuar një vendim kufizues ndaj meje si prind shoqërues. Këto pretendime nuk mund të përdoren për të justifikuar as kufizimin e pranisë sime në klasë pranë fëmijës, as për të krijuar perceptimin se përgjegjësia për situatën e krijuar i takon prindit, ndërkohë që çështja lidhet drejtpërdrejt me mënyrën e menaxhimit të situatave që nxiteshin nga vetë drejtuesja.

Institucioni arsimor referon se më datë 11.12.2025 në shkollë ka mbërritur një vendim i AKAP, i cili sipas shkollës është marrë pas një peticioni të disa prindërve të klasës VI-B drejtuar Ministrisë së Arsimit.

Sipas citimit të paraqitur nga institucioni arsimor, drejtoria e shkollës duhet të: “Mos lejojë znj. M.D të qëndrojë në mjediset e klasës gjatë orëve të mësimi. Nxënësi duhet të vijojë të asistohet në klasë vetëm nga mësuesja ndihmëse në bashkëpunim me mësuesit lëndorë”.

Si prind dhe si palë drejtpërdrejt e prekur nga një vendim i tillë, nuk kam marrë asnjë njoftim, shkresë apo komunikim administrativ, i cili të më informonte për përmbajtjen e vendimit, bazën ligjore të tij apo mënyrën e zbatimit në raport me fëmijën tim. Mungesa e komunikimit zyrtar të këtij vendimi ka bërë që ai të zbatohet pa më dhënë mundësinë të informohem për përmbajtjen e tij, të paraqes qëndrimin tim si prind apo të ushtroj të drejtën për ta kundërshtuar atë në rrugë administrative ose ligjore. Një vendim i njëanshëm i cili ka ndërhyrë drejtpërdrejtë në procesin e integritetit të fëmijës në klasë, pa transparencë dhe pa përfshirjen e prindit në vendimmarrje, ndonëse bëhet fjalë për një çështje që lidhet drejtpërdrejt me mirëqenien dhe procesin arsimor të tij.

Ndërkohë si prind unë paraqisja shqetësimin tim tek punonjësja e MA sepse e gjithë situata ishte një sulm për të larguar fëmijën nga shkolla. Këto komunikime tregojnë se kam kërkuar në mënyrë të vazhdueshme ndërhyrjen e institucioneve për të garantuar arsimimin dhe mirëqenien e fëmijës.

Institucioni arsimor pretendon se, pas insistimit të prindit, më datë 07.01.2026 ZVAP ka sugjeruar mbështetjen e prindit për një periudhë një mujore, me qëllim lehtësimin e procesit të integritetit të nxënësit në shkollë.

Në fakt, më 05.01.2026 për shkak se fëmija nuk u pranua në institucion ju drejtova avokatit të popullit. Pas kësaj date fëmija u fut në mësim dhe u hartua një marrëveshje me nr. prot 90, datë 07.01.2026 e cila nuk bënte gjë tjetër vetëm se legjitimonte veçimin dhe izolimin e fëmijës.

Nuk u firmos nga unë si prind pasi u këshillova me avokatin e popullit. Drejtuesja e acaruar që një dokument i institucionit kishte kaluar në një institucion si Avokati i Popullit nis nga qëndrimet arbitrare dhe armiqësore. Prania ime nuk është privilegj as favor nga institucioni, por masë mbështetëse e përshtatje e arsyeshme për një fëmijë me nevoja specifike. Unë kam mbrojtur fëmijën, jo marrëveshje të njëanshme. Në marrëveshjen e paraqitur, të drejtat e mia si prind janë plotësisht të mohuara, duke e reduktuar rolin e tim në një prani pasive, pa të drejtë fjale, pa të drejtë mendimi dhe pa të drejtë ndërveprimi minimal në funksion të interesit të fëmijës”.

Me email-in datë 20.04.2026, ankuesja në mes të tjerash ka informuar se janë bërë 8 javë që fëmija i saj është pa mësim.

- Mbështetur në nenin 33/8, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, për shqyrtimin e mëtejshëm të ankesës, Komisioneri me shkresën nr. 363/5, datë 15.04.2026 njoftoi, palët për zhvillimin e seancës dëgjimore me datë 28.04.2026, për të parashtruar dhe argumentuar në mënyrë të drejtpërdrejtë pretendimet e palëve në proces.

Seanca dëgjimore u zhvillua në datën 28.04.2026, pranë Zyrës së Komisionerit, me praninë e ankueses znj. M.D dhe përfaqësueses së saj ligjore Av. E.S dhe me praninë e përfaqësueseve të shkollës Niket Dardani, Drejtore M.K, zëvendës drejtores znj. J.P me autorizimin nr. 136/1, datë 27.04.2026, psikologes së shkollës znj. M.P me autorizimin nr 136, datë 27.04.2026, përfaqësueseve së ZVAP Tiranë, znj. O.J dhe znj. R.K me autorizimin nr. 4680 dhe nr. 4681, datë 28.04.2026 dhe znj. S.K, Kryetare e Këshillit të Prindërve të shkollës dhe znj. L.LL, Kryetare e Këshillit të Prindërve të klasës VI-B.

Bazuar në nenin 80/1/b të Kodit të Procedurave Administrative dhe Rregullores së Brendshme të Komisionerit, u njoftuan palët se seanca dëgjimore do të regjistrohej dhe përmbajtja e saj do të përdoret si provë gjatë procesit të shqyrtimit të ankesës.

Gjatë seancës dëgjimore, subjekti ankues i qëndroi të njëjtave parashtrime që kishte bërë të njohura gjatë komunikimit shkresor.

Gjatë seancës dëgjimore, përfaqësuesit e shkollës “Niket Dardani”, i qëndruan të njëjtave parashtrime që kishin bërë të njohur gjatë komunikimit shkresor, si dhe në mes të tjerash deklaruan se: *“Situata ka filluar që në datë 26.08.2025 kur është bërë aplikimi për fëmijën pa informuar se është fëmijë me AK. Deri ditën e parë të shkollës nuk kemi pasur një kërkesë nga nga prindi për nxënës me AK. Në ditën e parë të shkollës prindi e ka shoqëruar fëmijën dhe ne si shkollë nuk kemi hezitur ta mirëpresim nxënësin në shkollë. Duke qenë se nuk kishim një plan për këtë nxënës duhet të prisnim planin nga Komisioni i ZVAP, i cili do të merrte vendimin për shërbimet e mësuesit ndihmës. Nxënësi D.D nuk është penguar asnjëherë për të hyrë në shkollë, por është ndaluar prindi. Sa herë që ka ardhur nxënësi në shkollë ka dalë mësuesja ndihmëse për ta shoqëruar në klasë.*

Asnjë nga shprehjet e deklaruara nga znj. M.D, se personeli i shkollës ka përdorur për nxënësin dhe znj. M.D nuk është e vërtetë”.

- Në mbështetje të neneve 78-86 të Kodit të Procedurave Administrative, nenit 32, pika 1, shkronja c), dhe pikat 2, 3 e 4 të këtij neni, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, si dhe nenit 39, të Rregullores së Brendshme “Për organizimin dhe funksionimin e Zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi³”, si dhe në zbatim të Urdhrit nr. 54, datë 28.04.2026, të Komisionerit, në datën 05.05.2026, Grupi i Inspektimit të KMD-së, realizuan një inspektim pranë Shkollës “Niket Dardani”.

Referuar procesverbalit të inspektimit datë 05.05.2026, inspektorët e KMD-së, morën takim me përfaqësuesit e shkollës dhe të GNP-së së ngritur për të ndjekur rastin e nxënësit D.D.M. Përfaqësuesit e shkollës deklaruan se: *“Në datë 04.05.2026 prindi me nxënësin kanë hyrë në klasë dhe kanë qëndruar për një orë mësimore në klasë. Në orën pasardhëse të gjithë fëmijët kanë marrë çantat dhe janë larguar nga klasa. Ata nuk kanë pranuar që në klasë të jetë prezent znj. M.D. Edhe në datë 05.05.2026 nxënësit nuk kanë pranuar që znj. M.D të jetë në klasë. Ndërkohë që znj. M.D*

³ <https://www.kmd.al/wp-content/uploads/2021/05/RREGULLORE-KMD.pdf>

nuk pranon të dalë nga klasa. Në këto kushte fëmijët nuk pranojnë të zhvillojnë mësim në prezencën e znj. M.D në klasë dhe po zhvillojnë mësimin në një klasë tjetër”.

Me shkresën e protokolluar me tonën me nr. 363/6, datë 28.04.2026, znj. M.D ka dërguar dokumentacion shtesë.

Me shkresën nr. 142, datë 06.05.2026, Shkolla “Niket Dardani” dërgoi dokumentacion shtesë dhe në mes të tjerash informoi se: *“Më poshtë po ju vëmë në dispozicion një informacion shtesë me hapat e marra nga shkolla dhe institucionet ndërvepruese në periudhën Janar-Maj 2026. Si vijon:*

Më datë 05.01.2026, znj. M.D paraqitet në shkollë me një person që prezantohet si administrator i portalit “Zhurma. al”, duke realizuar video me përmbajtje denigruese ndaj shkollës, MAS, ZVAP Tiranë dhe stafit mësimor duke përdorur informacion jo zyrtar dhe të deformuar .

Më datë 06.01.2026, prindi lejohet të futet në klasë pas ndërhyrjes se titullarit i ZVAP Tiranë dhe me praninë e tyre në mjediset e shkollës.

Më datë 07.01.2026, u zhvillua një takim me përfaqësues të ZVA-së dhe prindin e nxënësit, ku u ra dakord që prindi të shoqërojë fëmijën në ambientet e shkollës për një periudhë 1-mujore, me qëllim lehtësimin e procesit të përshtatjes.

Gjithashtu, në këtë takim u dakordësua që të përpilohet një marrëveshje 1-mujore, e cila do të përmbajë detyrimet dhe rregullat që duhet të respektohen nga prindi gjatë kësaj periudhe. Megjithëse gjatë takimit prindi ra dakord për hartimin e një marrëveshjeje 1-mujore, pasi kjo marrëveshje u përpilua nga ana e shkollës, prindi refuzoi ta nënshkruajë.

Pas kësaj periudhe prindit iu bë e qartë që në mënyrë të prerë të respektojë Rregulloren e Brendshme të Shkollës, Shkresën e AKAP, e cila qartësisht përcakton që prindi nuk duhet të qëndrojë në mjediset e klasës me nxënësit.

Më datë 15.01.2026, nga Njësia Administrative Nr. 1 u organizua mbledhja e Grupit Teknik Ndërinstitucional (GTN), në lidhje me trajtimin e rastit të nxënësit D.M.

Mbledhja u zhvillua pas referimit të rastit për dhunë psikologjike të ushtruar ndaj fëmijës nga nëna, bazuar në vëzhgimet e realizuara në mjediset e shkollës si dhe gjatë veprimtarive në ambiente të tjera. Gjatë kësaj mbledhjeje u shqyrtua në mënyrë të detajuar situata e nxënësit dhe u diskutuan problematikat e evidentuara.

Prindi refuzoi të marrë pjesë në këtë takim.

Më datë 29.01.2026, në takimin e përmuajshëm të Këshillit të Prindërve të klasës VI-B, u paraqit një ankesë nga prindërit lidhur me praninë e vazhdueshme të një prindi në ambientet e klasës gjatë zhvillimit të procesit mësimor. Prindërit u shprehën se prania e tij shoqërohet me ndërhyrje të papërshtatshme, konkretisht duke bërë mimika me fytyrë ndaj nxënësve kur ata nuk përgjigjen saktë në mësim, si dhe duke kontrolluar çantat dhe bankat e nxënësve me pretendimin për praninë e mjeteve përgjuese.

Sipas prindërve, këto veprime ndikojnë negativisht në përqendrimin e nxënësve, krijojnë ndjesi pasigurie dhe cenojnë klimën e nevojshme për zhvillimin normal të procesit mësimor.

Pas diskutimeve të zhvilluara në takim, Këshilli i Prindërve vendosi që: “T’i kërkohet shkollës të marrë masa për kufizimin e pranisë së prindit në ambientet e klasës gjatë orës mësimore, në përputhje me vendimin AKAP dhe rregulloren e brendshme të shkollës”.

Më datë 13.02.2026, para fillimit të procesit mësimor, në ambientet e shkollës janë paraqitur disa përfaqësues të Këshillit të Prindërve, si dhe prindër të tjerë të nxënësve.

Sipas të pranishmëve, është tentuar një komunikim me prindin në fjalë, me qëllim trajtimin e disa çështjeve që lidhen me ecurinë dhe mirëfunksionimin e procesit shkollor. Megjithatë, komunikimi nuk është realizuar, pasi prindi ka refuzuar çdo formë dialogu.

Gjithashtu, raportohet se gjatë kësaj situatë prindi ka përdorur ton kërcënues ndaj prindërve të tjerë të pranishëm, duke kërkuar prej tyre emrin, mbiemrin dhe vendin e punës.

Në seancën dëgjimore kanë qenë të pranishëm edhe Kryetarja e Këshillit të Prindërve të shkollës dhe Kryetarja e Këshillit të Prindërve të klasës VI-B, të cilat shprehën dëshirën që ky rast të evidentohet dhe të dokumentohet zyrtarisht.

Më datë 16.02.2026, është konstatuar se nxënësit kanë braktisur procesin mësimor dhe kanë refuzuar zhvillimin e orës mësimore në prani të prindit, znj. M.D, në ambientet e klasës. Kjo situatë është përsëritur për një periudhë prej një jave rresht, ku nxënësit nuk kanë pranuar të vazhdojnë mësimin në kushtet e pranisë së prindit në klasë.

Pavarësisht komunikimeve dhe bisedave të zhvilluara me prindërit, nuk është arritur asnjë zgjidhje apo përmirësim i situatës.

Nxënësit janë shprehur se kanë marrëdhënie shoqërore të mira me bashkëmoshatarin dhe e konsiderojnë atë shok të afërt, por kanë deklaruar se prania e nënës së tij në klasë dhe sjelljet e saj gjatë orës mësimore, sipas tyre, kanë përfshirë fyerje dhe qëndrime denigruese ndaj nxënësve.

Nxënësit përgjigjen që nxënësin e kanë shok dhe shumë xhan por nëna e tij i fyen dhe i denigron në orë mësimi.

Më datë 24.02.2026, prindi i nxënësit nuk ka lejuar fëmijën të futet në ambientet e shkollës pa praninë e saj. Në vijim të kësaj situatë, prindi ka depozituar kallëzim pranë Komisarariatit të Policisë Nr. 4, duke pretenduar për problematika në procesin e ndjekjes së shkollës. Shkolla, në përmbushje të detyrimeve ligjore dhe institucionale, ka reaguar zyrtarisht duke i dërguar shkresë sqaruese Komisarariatit të Policisë Nr. 4, në të cilën është shpjeguar situata reale dhe rrethanat e ngjarjes, si dhe masat e ndërmarra nga institucioni arsimor për garantimin e zhvillimit normal të procesit mësim.

Më datë 25.02.2026, prindi paraqitet me një person të cilën e prezanton si avokate e saj, duke pretenduar ne ndihmën e përmirësimit të situatës. Me pretendimin e personit të paraqitur si avokate

e Znj. M.D, lejoj që nëna të shoqëroje fëmijën deri në klasë dhe të lejojë zhvillimin normal të mësimit. Nëna futet në mjediset e brendshme të klasës dhe nuk del pas ndërhyrjes së personit shoqërues me tone të ashpër merr nxënësin dhe largohet nga mjediset e shkollës pa dhënë asnjë shpjegim, reflektimi i prindit nuk ka qenë pozitiv. Mësuesja ndihmëse pret si çdo ditë nxënësin në oborrin e shkollës.

Më datë 04.03.2026, prindi i nxënësit është futur në mënyrë të paautorizuar në ambientet e jashtme (oborrin) të shkollës, pa lejen e institucionit dhe në kundërshtim me rregulloren e brendshme të saj. Për shkak të situatës së krijuar, është bërë menjëherë njoftimi i Policisë së Shtetit, si dhe i SPZ-së së zonës, për të garantuar rendin dhe sigurinë në ambientet e shkollës dhe për menaxhimin e mëtejshëm të situatës.

Më datë 17.03.2026, prindi i nxënësit vijon të mos lejojë fëmijën të ndjekë procesin mësimor pa praninë e saj në ambientet e shkollës. Mësuesja ndihmëse, në përmbushje të detyrës së saj dhe sipas praktikës së përditshme të ndjekur për rastin në fjalë, ka pritur nxënësin në oborrin e shkollës, me qëllim shoqërimin e tij në procesin mësimor.

Më datë 25.03.2026, në ambientet e shkollës u organizua nga Zyra Vendore Arsimore, Tiranë, një takim i zgjeruar në lidhje me rastin e nxënësit, me pjesëmarrjen e Njesisë së Shërbimit Psikosocial, PMF NJ.3 dhe Farkë (deleguar rasti për ndjekje), si dhe përfaqësues të ASHDMF. Në takim ishte i ftuar edhe prindi i nxënësit, e cila u paraqit e shoqëruar nga një përfaqësuese e Dhomës Juridike për Ofrim të Ndhmës Falas, pa paraqitur autorizim për pjesëmarrje në cilësinë e përfaqësueses ligjore.

Gjatë takimit, prindi refuzoi sërish të marrë pjesë në mënyrë aktive në diskutim dhe nuk shfaqti gatishmëri për bashkëpunim me institucionet përkatëse, duke mos kontribuar në gjetjen dhe zgjidhjen për rastin.

Më datë 08.04.2026, Njësia Administrative Farkë (e deleguar për ndjekjen e rastit të nxënësit D.M., pas dorëheqjes së punonjësës së Njesisë Administrative Nr. 1), organizoi mbledhjen e Grupit Teknik Ndërdisciplinor (GTN), me qëllim trajtimin e situatës dhe koordinimin e veprimeve për riintegrimin e nxënësit D.M. në procesin mësimor.

Për këtë mbledhje është njoftuar edhe prindi i nxënësit për të qenë pjesë e diskutimeve dhe për të kontribuar në gjetjen e zgjidhjeve të përshtatshme për rastin. Megjithatë, prindi ka refuzuar të marrë pjesë dhe nuk ka shprehur gatishmëri për bashkëpunim me aktorët institucionalë dhe ndërveprues të përfshirë në menaxhimin e rastit.

Më datë 27.04.2026, u zhvillua mbledhja e Grupit Teknik Ndërdisciplinor (GTN) në ambientet e Bashkisë Tiranë, e drejtuar nga znj. M.L, Punonjëse për Mbrojtjen e Fëmijës pranë Njesisë Administrative Farkë.

Në këtë takim morën pjesë përfaqësues nga institucione dhe struktura të ndryshme, konkretisht: drejtuesja e NJSHPS, DRAP Tiranë znj. O.J, drejtoresha e shkollës “Niket Dardani” znj. M.K, shërbimi psikosocial i shkollës znj. N.S, psikologja znj. M.P, përfaqësuese nga Qendra Komunitare

Shkozë znj. L.M, përfaqësuese nga Qendra Komunitare e Shëndetit Mendor Nr. 1 znj. A.M, përfaqësues i strukturës për dhunën në familje dhe të mitur pranë Drejtorisë Vendore të Policisë z. A.P, si dhe punonjësja për Mbrojtjen e Fëmijëve pranë Njesisë Administrative Nr. 3 znj. D.B.

Qëllimi i mbledhjes ishte trajtimi i rastit dhe përcaktimi i hapave konkrete për riintegrimin e nxënësit D.M. në procesin mësimor, si dhe koordinimi ndërinstitutional për menaxhimin e situatës.

Gjatë takimit u diskutuan problematikat e evidentuara, u analizua situata aktuale e nxënësit dhe u përcaktuan masat konkrete për të mundësuar rikthimin dhe përshtatjen e tij në ambientin shkollor, duke u theksuar organizimi i procesit pa praninë e prindit në klasë.

Prindi i nxënësit ishte i ftuar për të marrë pjesë në këtë mbledhje, por refuzoi sërish pjesëmarrjen dhe nuk u angazhua në bashkëpunim me institucionet përgjegjëse.

Në përfundim të mbledhjes, nga grupi i punës u hartua dhe u miratua një plan ndërveprimi për riintegrimin e nxënësit D.M..

Plani i Integritimit Gradual në Shkollë dhe ambientim me Mësuesen Ndhmese për 4 javë.(I detyruar për zbatim nga data 04.05.2026)

Më datë 04.05.2026 në portën e shkollës me gazetarë të emisionit investigativ “Stop” të cilët kërkuar thjesht dhe vetëm, detyrimisht, futjen e nënës në mjediset e klasës edhe pse u sqaruan për situatën në të cilën gjendej klasa VI-B. Pas marrjes se lejes për informim nga DRAP Tiranë, ju vu në dispozicion gjithë praktikën e ndjekur nga shkolla për zgjidhjen e çështjes që nxënësi të bëhej pjesë integrale e klasës. Prindi edhe pse në “Planin e Integritimit Gradual në shkollë” ishte vendosur që do të qëndronte në korridor u fut në mjediset e klasës. Nxënësit e klasës dalin menjëherë sa përfundon ora mësimore dhe nuk pranojnë të futen në klasë nëse prania e prindit do të vazhdojë .

Për këtë qëllim sot në datën 04.05.2026, ora 16.00, me sugjerim edhe të DRAP Tiranë u organizua një takim me prindërit e klasës së VI-B, në përpjekje për të gjetur mbështetjen e tyre në dhënien e një mundësie prindit të qëndroje në klasën përkohësisht deri 3-4 ditë për atashimin e nxënësit D.M.

Qëndrimi i prindërve ishte kundërshtues dhe me kërkesë të vazhdueshme, duke theksuar përgjegjësinë që shkolla ka në zbatimin e Rregullores së Brendshme të Shkollës, si dhe të shkresës së AKAP-it, e cila ngarkon Drejtorinë e Shkollës me detyrimin për moslejimin e prindit të qëndrojë në klasë dhe për sigurimin e ndjekjes së nxënësit nga mësuesja ndihmëse.

Nga plani u ngarkuan një psikologe e ZVAP Tiranë dhe një punonjëse e PMF Njësia Administrative Nr.3 (duke qenë se prindi kundërshton qasjen me psikologjen dhe punonjësen sociale të shkollës u kërkuar përfshirja e aktorëve të jashtëm nga shkolla në GTN) për të menaxhuar rastin dhe për të integruar në mënyre graduale nxënësin në mjediset e klasës. Duke filluar nga data 04.05.2026 janë koordinuar veprimet ndërmjet grupit teknik dhe prindit të nxënësit D.M për të gjetur rrugë dhe mënyra të ndërveprimit ndërmjet tyre dhe gradualisht për të realizuar shkëputjen e nxënësit dhe përfshirjen në procesin mësimor.

Për 3 ditët e para me gjithë përpjekjet edhe të grupit teknik prindi nuk pranon të bashkëpunojë për të respektuar pikat e planit por përsëri kërkon dhe imponohet përfshirjes në mjedisin e klasës duke shoqëruar nxënësin. Përsëri nxënësit e klasës kanë reaguar duke kërkuar lejin për zhvillimin e një procesi të qetë mësimor pa praninë e prindit në mjediset e klasës. U punua nga mësueset kujdestare dhe shërbimi psikosocial për një mbështetje të nxënësit në mjedis dhe krijimit të lehtësirave në marrëdhënie të nxënësve ndërmjet tyre, në orë të veçanta u gjet ky bashkëpunim.

Megjithatë këto tre ditë të para të riintegritimit të nxënësit në shkollë, është vërejtur një qasje pozitive e tij ndaj procesit mësimor dhe ambientit të klasës nga nxënësi. Gjithashtu, janë evidentuar hapa të vegjël bashkëpunues edhe nga ana e klasës, në drejtim të përfshirjes së fëmijës në orët mësimore dhe mbështetjes së frekuentimit të rregullt të shkollës.

Si përfundim:

Nxënësi ka frekuentuar procesin mësimor vetëm në rastet kur prindi është lejuar të qëndrojë në ambientet e institucionit shkollor. Në rastet kur prindi nuk është lejuar të qëndrojë brenda shkollës, ai nuk ka lejuar as fëmijën të hyjë apo të marrë pjesë në procesin mësimor.

Në disa raste të evidentuara, kur prindi është futur në ambientet e klasës në mënyrë të papërshtatshme dhe në kundërshtim me rregulloren e brendshme të institucionit, është konstatuar se nxënësit e klasës VI-B kanë bojkotuar procesin mësimor për një periudhë rreth një jave, si pasojë e situatave të krijuara dhe ndikimit të drejtpërdrejtë në klimën e sigurisë dhe të qetësisë në klasë.

Këto veprime kanë cenuar zhvillimin normal të procesit mësimor, disiplinën në institucion dhe të drejtën e nxënësve të tjerë për një mjedis të sigurt, të qetë dhe të mbrojtur arsimor.

Për shkak të vështirësive të hasura në sigurimin e frekuentimit të rregullt të nxënësit në shkollë, si dhe mospranimit nga ana e prindit të mësueses ndihmëse, institucioni ka ndërmarrë masa të vazhdueshme administrative dhe profesionale për lehtësimin e përshtatjes së nxënësit në mjedisin shkollor.

Në këtë kuadër janë hartuar plane individuale të mbështetjes dhe atashimit të nxënësit, duke përfshirë bashkëpunimin me mësuesen ndihmëse dhe strukturat psiko-sociale të shkollës, me qëllim integrimin e plotë të tij në procesin mësimor dhe rritjen e pjesëmarrjes së rregullt.

Nxënësi nuk ka ndjekur në mënyrë të rregullt procesin mësimor gjatë periudhës së fundit. Mungesat e evidentuara lidhen me moslejimin nga ana e prindit për ndjekjen e procesit mësimor sipas organizimit institucional dhe rregullave të brendshme të shkollës, dhe jo për shkaqe të natyrës shëndetësore apo të aftësisë së kufizuar.

Institucioni arsimor ka ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme për garantimin e përfshirjes së nxënësit në procesin arsimor, përfshirë angazhimin e Punonjësve për Mbrojtjen e Fëmijëve (PMF) të Njësisë Administrative Nr. 1, Nr. 3 dhe Farkë, si dhe bashkëpunimin me Zyrën Vendore të Arsimit Parauniversitar Tiranë. Pavarësisht këtyre ndërhyrjeve institucionale, zbatimi i masave ka hasur vështirësi për shkak të situatave të krijuara nga sjelljet e përsëritura të prindit.

Përfundimisht, institucioni shkollor mbetet i angazhuar për mbrojtjen e interesit më të lartë të fëmijës, si dhe për garantimin e sigurisë, integritetit dhe të drejtës për arsimim të barabartë të të gjithë nxënësve të klasës VI-B. Shkolla do të vijojë të ushtrojë funksionet e saj në mënyrë të rregullt, duke garantuar zbatimin e Rregullores së Brendshme të Institucionit dhe të legjislacionit në fuqi, si dhe duke forcuar masat mbrojtëse për mbarëvajtjen e procesit mësimor dhe sigurinë e mjedisit shkollor.

Referencë: Shkresa e AKAP nr. 3003 Prot., datë 11.12.2025, “Kërkesë për marrjen e masave për moscënimin e procesit mësimor”.

Theksojmë se, ashtu siç është kundërshtuar edhe në seancën dëgjimore, shkolla dhe punonjësit e saj kanë vepruar në çdo rast në mënyrë korrekte, profesionale dhe në përputhje me detyrimet institucionale dhe rregulloret në fuqi. Komunikimi me znj. M.D ka qenë i kujdesshëm, i matur dhe gjithmonë në funksion të zgjidhjes së situatave në interes të procesit mësimor dhe mirëqenies së nxënësit.

Gjithashtu, punonjësit e shkollës kanë treguar gatishmëri për bashkëpunim dhe transparencë, duke respektuar procedurat zyrtare dhe duke shmangur çdo formë konflikti apo sjelljeje të papërshtatshme. Në këtë kuadër, pretendimet e paraqitura nga znj. M.D nuk pasqyrojnë mënyrën reale të komunikimit dhe sjelljes së stafit të shkollës”.

Në vijim ankuesja me email-et datë: 11.05.2026; 12.05.2026; 15.05.2026; 21.05.2026; 15.06.2026 dhe 16.06.2026; 18.06.2026; 19.06.2026; 22.06.2026; 23.06.2026; 24.06.2026; 02.07.2026; 06.07.2026; 08.07.2026 dhe 20.07.2026 ka dërguar kundërshtimet e saj lidhur me plani PEI, vlerësimin dhe testimin në klasë të djalit të saj, mungesat, etj.

- Me shkresën nr. 363/2, datë 17.06.2026, Komisioneri ka kërkuar nga shkolla informacion lidhur me frekuentimin e mësimit dhe kriteret e vlerësimit për nxënësin D.D.M.

Me shkresën nr. 165, datë 18.06.2026, Shkolla “Niket Dardani”, dërgoi dokumentacionin e kërkuar dhe në mes të tjerash informoi se: “Pas datës 06.05.2026 dhe deri në përfundim të vitit shkollor 2025–2026, nxënësi D.M ka frekuentuar rregullisht procesin mësimor në institucionin arsimor “Niket Dardani”. Gjatë kësaj periudhe nxënësi është shoqëruar çdo ditë nga prindi, znj. M.D.

Shkolla ka vijuar të garantojë zhvillimin normal të procesit mësimor, duke ofruar mbështetjen e mësueses ndihmëse, të stafit pedagogjik dhe të shërbimit psiko-social, në përputhje me nevojat individuale të nxënësit dhe me detyrimet ligjore të institucionit arsimor.

Sqarojmë se prania e vazhdueshme e prindit në mjediset e shkollës nuk ka qenë rezultat i një vendimmarrjeje apo autorizimi të institucionit arsimor. Prindi ka qëndruar në ambientet e shkollës pa miratimin paraprak të drejtimit të shkollës, ndërkohë që institucioni ka vijuar të ushtrojë detyrimet e tij për të garantuar mbarëvajtjen e procesit mësimor dhe interesin më të mirë të nxënësit.

Nga vëzhgimet e stafit pedagogjik dhe të mësueses ndihmëse rezulton se nxënësi ka shfaqur sjellje të qetë dhe bashkëpunuese gjatë qëndrimit në shkollë. Gjithashtu, në disa raste ai ka shprehur dëshirën për t'u përfshirë në aktivitete të përbashkëta me bashkëmoshatarët e tij. Megjithatë, përfshirja e tij në këto aktivitete nuk është realizuar, pasi prindi ka kërkuar që nxënësi të vijonte të fokusohet në përgatitjen për provimet, duke preferuar që ai të qëndronte në ambientet e klasës për të zhvilluar aktivitetet mësimore individuale. Shkolla ka respektuar rolin prindëror, duke vijuar njëkohësisht të inkurajojë përfshirjen sociale dhe pjesëmarrjen e nxënësit në jetën e klasës, në përputhje me parimet e arsimit gjithëpërfshirës.

2. Lidhur me kriteret e vlerësimit të nxënësit D.M në përfundim të procesit mësimor

Procesi i vlerësimit të nxënësit D.M është zhvilluar në përputhje me legjislacionin në fuqi për arsimin parauniversitar dhe aktet nënligjore përkatëse, mbi bazën e Planit Edukativ Individual (PEI), i cili është hartuar nga mësuesja ndihmëse në bashkëpunim me psikologun e institucionit dhe prindin e nxënësit.

Vlerësimi është mbështetur në objektivat minimale të përcaktuara në PEI, duke marrë në konsideratë aftësitë, ritmin e të nxënësit, progresin individual dhe nevojat specifike të nxënësit.

Bazuar në përmbushjen e objektivave të Planit Edukativ Individual dhe në progresin e arritur gjatë vitit shkollor, nxënësi përfundoi vitin shkollor me sukses duke arritur një mesatare mbi 9.5. Ky vlerësim është kryer në mënyrë objektive, profesionale, duke respektuar parimet e barazisë, gjithëpërfshirjes dhe interesin më të mirë të nxënësit”.

III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes

Në nenin 1 të ligjit nr. 10221/2010, i ndryshuar, parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, në nenin 1, sipërcituar dhe nenin 3/1, parashikojnë se: “‘Diskriminim’ është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi”.

Gjatë shqyrtimit të ankesës dhe ndjekjes së procedurës hetimore, Komisioneri në përputhje me ligjin ka kërkuar informacionin e nevojshëm dhe dokumentacionin mbështetës, lidhur me rastin e

subjektit ankues, në mënyrë që të mund të vlerësonte me objektivitet pretendimin e subjektit për trajtim të padrejtë dhe diskriminues.

Komisioneri ka përmbushur kërkesat e parashikuara në Kodin e Procedurës Administrative, edhe sa i takon dhënies së ndihmës efektive, gjë e cila është përcaktuar në nenin 10, të tij: *“Organi publik siguron që të gjitha palët dhe persona të tjerë të përfshirë në procedurë të jenë në gjendje të ndjekin dhe të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre ligjorë në mënyrë sa më efektive dhe të lehtë të jetë e mundur. Ai i informon palët mbi të drejtat dhe detyrimet e tyre, përfshirë të gjithë informacionin e lidhur me procedurën dhe i paralajmëron ato për pasojat ligjore të veprimeve ose mosveprimeve të tyre”*.

Ligji 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, i ndryshuar, në nenin 32/2, të tij ka përcaktuar qartë këtë detyrim, duke cituar se: *“Të gjitha institucionet publike dhe subjektet private janë të detyruara të mbështesin Komisionerin, duke i dhënë informacionin që i nevojitet dhe duke i garantuar aksesin në informacionin në përmbushjen e detyrave të tij”*.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur, rezulton se:

Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror, Tiranë, me vendimin nr. AK-2024-028341, datë 18.09.2024, të Komisionit Shumëdisiplinor të Vlerësimit të Aftësisë së Kufizuar ka njohur statusin e aftësisë së kufizuar të D.D.M, me diagnozat “Çrregullim i Spektrit Autik” dhe “prapambetje mendore e moderuar”.

Në fillim të vitit shkollor 2025–2026, D.D.M rezulton të jetë regjistruar fillimisht në klasën VI-A dhe pastaj ka kaluar në klasën VI-B të shkollës 9-vjeçare “Niket Dardani”, Tiranë.

Komisioni i shkollës për nxënësit me aftësi të kufizuara me vendimin datë 12.09.2025, ka vendosur që nxënësi D.M të shoqërohet nga prindi gjatë procesit mësimor deri në momentin që do të vijë rekomandimi nga Komisioni Multidisiplinar nga ZVAP Tiranë.

ZVAP Tiranë me shkresën nr. 9610/1, datë 08.10.2025, ka dërguar në shkollën “Niket Dardani” rekomandimin e Komisionit Multidisiplinar për Aftësinë e Kufizuar, për nxënësin D.D.M, që të asistohet me mësues ndihmës 12 orë/javë.

ZVAP Tiranë në datë 10.10.2025 caktoi znj. F.B si mësuese ndihmëse për nxënësin D.D.M.

Pas fillimit të punës së mësueses ndihmëse filluan dhe mosmarrëveshjet mes personelit të shkollës dhe prindit të nxënësit. Sipas shkollës, kjo mësuese ishte caktuar nga ZVAP Tiranë dhe ishte “e aftë të punonte me nxënësit me aftësi të kufizuara”. Sipas prindit, marrëdhënia ndërmjet fëmijës dhe mësueses ndihmëse nuk funksionoi, pasi fëmija nuk e pranonte praninë e saj dhe shprehej se nuk ndihej i kuptuar dhe i mbështetur prej saj. Prindi kërkoi të qëndronte pranë fëmijës, duke pretenduar se prania e saj ishte e nevojshme për stabilitetin emocional dhe integrimin gradual të tij. Shkolla e vlerësoi këtë prani si ndërhyrje në procesin mësimor, ndërsa prindi e konsideroi përshtatje të arsyeshme të nevojshme për fëmijën.

Ankuesja me email-in datë 16.10.2025, drejtuar shkollës ka kërkuar lejimin e saj në klasë për të asistuar djalit gjatë procesit mësimor dhe pezullimin e përkohshëm të ndërhyrjeve që shkaktojnë ankth dhe ngarkesë emocionale tek fëmija i saj.

Shkolla me shkresën nr. 32, datë 21.10.2025 ka njoftuar ZVAP Tiranë për lejimin e përkohshëm të prindit Znj. M.D gjatë procesit mësimor duke filluar nga data 22.10.2025 deri më 04.11.2025, me qëllim lehtësimin e përshtatjes së fëmijës dhe forcimin gradual të raportit të besimit me mësuesen ndihmëse.

Me datë 21.10.2025 nga komisioni i shkollës është hartuar dhe plani individual 10 ditor për nxënësin, plan për të cilin ankuesja nuk ka qenë dakord për arsye se “plani i punës është përpiluar nga persona që nuk njohin vështirësinë dhe shpërthimet e djalit të saj”.

Prindi i është drejtuar shkollës me email datë 03.11.2025, duke ngritur shqetësime për mënyrën e trajtimit të fëmijës, marrëdhënien me mësuesen ndihmëse, daljen e nxënësve të tjerë nga klasa dhe ndikimin që këto episode kishin në gjendjen emocionale dhe në pjesëmarrjen e D.D.Mit në mësim.

Shkolla me shkresën nr. 40, datë 06.11.2025, ka njoftuar znj. M.D mbi respektimin e rregullave të institucionit arsimor dhe rolin e mësueses mbështetëse dhe duke e informuar se prania e saj në mjediset e shkollës bie ndesh me legjislacionin për institucionin e arsimit parauniversitar.

Një grup prindërisht të nxënësve të klasës VI-B me shkresën datë 06.11.2025, i paraqitën një kërkesë Ministrisë së Arsimit, ZVAP Tiranë dhe institucioneve të tjera arsimore. Në kërkesë pretendohet se prania e M.D në klasë dhe ndërhyrjet e saj gjatë orëve mësimore cenonin zhvillimin normal të procesit, qetësinë e nxënësve dhe autoritetin e mësuesve. Prindërit kërkuan marrjen e masave për largimin e saj nga klasa dhe garantimin e një mjedisi të qetë e të sigurt për nxënësit.

Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar me shkresën nr. 3003/1, datë 11.12.2025, “Kërkesë për marrjen e masave për moscënimin e procesit mësimor” ka njoftuar shkollën “Niket Dardani” si më poshtë: *“AKAP kërkon nga drejtoria e shkollës marrjen e masave për moscënimin e procesit mësimor dhe moslejimin e znj. M.D të qëndrojë në mjediset e klasës gjatë orëve të mësimit. Nxënësi duhet të vijojë të asistohet në klasë vetëm nga mësuesja ndihmëse në bashkëpunim me mësuesit lëndor”*.

Në datë 07.01.2026 mes shkollës dhe prindit është lidhur një marrëveshje bashkëpunimi dhe angazhimi me objekt përcaktimin e kushteve, rregullave dhe kufizimeve për praninë e prindit në ambientin e klasës, me qëllim mbështetjen e përshtatjes së nxënësit me AK në procesin mësimor dhe garantimin e mbarëvajtjes së procesit mësimor duke filluar nga data 07.01.2026 deri më 07.02.2026.

Sipas prindit, marrëveshja: kufizonte rolin e saj në proces; nuk përmbante masa të mjaftueshme për përshtatjen e fëmijës; nuk parashikonte përgjegjësi konkrete për shkollën; nuk ishte dakordësuar realisht dhe nuk ishte nënshkruar prej saj.

Sipas shkollës, marrëveshja kishte për qëllim krijimin e kushteve për vijimin e procesit mësimor dhe kufizimin e ndërhyrjeve të prindit gjatë orëve.

Nga komunikimet rezulton se, pas një periudhe të parë ndërprerjeje, fëmija në janar u rikthye në mësim. Prindi pretendon se menjëherë pas rikthimit ai u vendos përpara testeve dhe kërkesave që nuk merrnin parasysh periudhën e munguar dhe nevojën për përshtatje graduale.

Shkolla “Niket Dardani” me shkresën nr. 12/3, datë 18.02.2026, ka bërë ndryshimin e mësueses ndihmëse të nxënësit D.D.M, pas pretendimeve të vazhdueshme të prindit Znj. M.D, për papërshtatshmëri të djalit të saj me mësuesen ndihmëse F.B duke caktuar mësuesen A.D.

Me email të datës 20.02.2026, ankuesja njoftoi ZVAP Tiranë, AKAP Tiranë dhe koordinatoren përkatës se fëmija kishte shtatë ditë pa mësim dhe se hyrja e tij pengohet fizikisht në derën e shkollës. Prindi kërkoj ndërhyrje institucionale, duke pretenduar diskriminim, izolim publik dhe moszbatim të detyrimit për arsim gjithëpërfshirës.

Nga komunikimet e prindit dhe dokumentacioni i mëvonshëm rezulton se nxënësi rifilloi frekuentimin e mësimit më 07.05.2026, pas një shkëputjeje të deklaruar prej rreth 10–11 javësh.

Rikthimi u shoqërua me: hartimin ose rishikimin e PEI-së; teste në disa lëndë; detyra dhe projekte; monitorim nga struktura të shkollës dhe institucione të tjera; komunikime të vazhdueshme ndërmjet prindit, shkollës, ZVAP-së, KMD-së dhe Avokatit të Popullit.

Në periudhën pas kthimit në shkollë të djalit të saj, ankuesja ka dërguar disa email-e në të cilat ka kundërshtuar planin PEI, mënyrën e pyetjeve në lëndë të ndryshme dhe kundërshtime të vlerësimeve të djalit të saj.

Në datë 18.06.2026, shkolla ka lëshuar dëftesën e nxënësit, tabelën e notave përfundimtare dhe dokumente shoqëruese për përfundimin e klasës VI. Në dëftesë rezulton se nxënësi D.D.M ka përfunduar klasën e VI me notë mesatare vjetore 9.53 dhe me mungesa të paarsyetuara 305.

Legjislacioni i zbatueshëm që rregullon sistemin arsimor parauniversitar:

Arsimi parauniversitar në Republikën e Shqipërisë rregullohet nga ligji nr. 69/2012 *“Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”*, i ndryshuar, i cili në nenin 1 përcakton objektin, qëllimin dhe fushën e zbatimit të tij, ndërsa në nenin 4 sanksionon se sistemi arsimor parauniversitar funksionon në përputhje me Kushtetutën, legjislacionin shqiptar në fuqi dhe vlerat e sistemeve arsimore bashkëkohore.

Neni 5, pika 1 i ligjit nr. 69/2012 parashikon se: *“1. Në Republikën e Shqipërisë garantohet e drejta për arsimimin e shtetasve shqiptarë, të huaj dhe personave pa shtetësi, pa u diskriminuar nga gjinia, raca, ngjyra, etnia, gjuha, orientimi seksual, bindjet politike ose fetare, gjendja, ekonomike apo sociale, mosha, vendbanimi, aftësia e kufizuar ose për arsye të tjera që përcaktohen në legjislacionin shqiptar...”*.

Neni 6, përcakton parimet e përgjithshme të Ligjit nr. 69/2012, ku parashikohen ndër të tjera se: *“1.Në veprimtaritë e institucioneve të sistemit arsimor parauniversitar, interesi i nxënësit është parësor. 2. Në sistemin arsimor parauniversitar respektohen, mbrohen dhe promovohen të drejtat*

e liritë e njeriut në përgjithësi dhe të drejtat e fëmijëve në veçanti. 3. Në sistemin arsimor parauniversitar, nxënësve dhe punonjësve u ofrohet mbrojtje nga çdo formë veprimi ose mosveprimi që mund t'u shkaktojë diskriminim, dhunë, keqtrajtim ose dëm moral. 4. Në institucionet arsimore zbatohet parimi i gjithëpërfshirjes së nxënësve. 5. Çdo nxënës i sigurohet e drejta për arsimim cilësor, si dhe shanse të barabarta për arsimim. 6. Nxënësve të familjeve në nevojë, nxënësve me aftësi të kufizuara dhe atyre me vështirësi në të nxënë u ofrohet përkujdesje e posaçme, sipas përcaktimeve në këtë ligj... ”.

Neni 54, i ligjit nr. 69/2012, “Drejtori i Institucionit Arsimor” përcakton se: *“1. Drejtori drejton veprimtarinë e institucionit arsimor. 2. Drejtori i institucionit arsimor, publik ose privat, është përgjegjës për: a) zbatimin e këtij ligji dhe të akteve nënligjore në zbatim të tij; b) përmirësimin e cilësisë së shërbimit arsimor; c) zbatimin dhe zhvillimin e kurrikulës; ç) menaxhimin e personelit dhe krijimin e kushteve për zhvillimin profesional të punonjësve të institucionit. 3. Drejtori i institucionit arsimor publik kryen edhe këto detyra: a) menaxhon institucionin, përfshirë edhe menaxhimin financiar; b) ”.* Kjo dispozitë e ngarkon drejtuesin e shkollës me përgjegjësi të drejtpërdrejtë për zbatimin korrekt të detyrimeve që burojnë nga legjislacioni për fëmijët me aftësi të kufizuara.

Neni 62 i ligjit nr. 69/2012 përcakton se prindërit janë partneri kryesor i institucionit arsimor në mbarëvajtjen e fëmijës dhe të institucionit. Pozita e prindit si “partner kryesor” nënkupton të drejtën për t'u informuar, për t'u dëgjuar, për të paraqitur kërkesa dhe propozime dhe për të marrë pjesë në vendimmarrjet që lidhen me arsimimin dhe mbështetjen e fëmijës. Megjithatë, kjo pozitë nuk barazohet me ushtrimin e kompetencave pedagogjike ose drejtuese të institucionit dhe nuk krijon, në vetvete, një të drejtë të pakufizuar të prindit për të qëndruar në klasë gjatë zhvillimit të orëve mësimore.

Kreu XI i ligjit nr. 69/2012, Arsimimi i fëmijëve me aftësi të kufizuara, parashikon: Neni 63 “Parime të arsimimit të fëmijëve me aftësi të kufizuara”: *“1. Arsimimi i fëmijëve me aftësi të kufizuara synon zhvillimin e plotë të potencialit intelektual e fizik dhe përmirësimin e cilësisë së jetës së tyre për t'i përgatitur për integrim të plotë në shoqëri dhe në tregun e punës. 2. Përfshirja e fëmijëve me aftësi të kufizuara në institucionet arsimore të specializuara për ta është përgjithësisht e përkohshme. Përfshirja dhe integrimi i fëmijëve me aftësi të kufizuara në kopshtet dhe shkollat e zakonshme të arsimit bazë është parësore. 3. ”.*

Neni 64, i ligjit nr. 69/2012, përcakton se: *“1. Nxënësve me aftësi të kufizuara u sigurohet arsimimi në shkollat e arsimit të mesëm të lartë, sipas kriterëve të miratuara nga ministri dhe Ministri i Shëndetësisë. 2. Nxënësi me aftësi të kufizuara qëndron në shkollë të specializuara deri në moshën 19 vjeç. 3. Njësia arsimore vendore krijon një komision, të përbërë nga mjekë, psikologë, mësues dhe specialistë për fëmijët me aftësi të kufizuara, i cili, pasi shqyrton kërkesën e prindit ose të drejtorit të një institucioni arsimor, jep rekomandimet përkatëse për ndjekjen nga fëmija të një institucioni arsimor të zakonshëm a të specializuar. 4. Prindërit vendosin nëse fëmija e tyre me aftësi të kufizuara do të ndjekë një institucion të specializuar ose të zakonshëm të arsimit bazë.*

Prindërit mund të largojnë në çdo kohë nga shkolla fëmijën, kur e gjykojnë se ai nuk përfiton nga mësimet ose ka mundësi të tjera më të mira. 5. Ministria, në bashkëpunim me njësinë bazë të qeverisjes vendore dhe në këshillim me prindërit e komisionin, siguron arsimimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara në njërin nga dy llojet e institucioneve arsimore, të zakonshme ose të specializuara...”.

Neni 65, “Organizimi i arsimit të fëmijëve me aftësi të kufizuara: “ 1. Nxënësit me aftësi të kufizuara mësojnë sipas planit mësimor e programeve lëndore të zakonshme, të përshtatura për ta, ose sipas planit mësimor e programeve lëndore të specializuara për ta. 2. Në institucionet arsimore të zakonshme, programi i personalizuar për nxënësin me aftësi të kufizuara hartohet nga një komision, në përbërje të të cilit janë mësues të fushave të ndryshme të të nxënës të institucionit e psikologë. Hartimi i këtij programi bëhet në bashkëpunim me prindërit e nxënësit. Ndryshimi i programit të personalizuar brenda një institucioni arsimor vendoset nga komisioni brenda institucionit, në bashkëpunim me prindërit e fëmijës. 3. Nxënësve me aftësi të kufizuara u sigurohen mësues ndihmës dhe shërbim rehabilitues, sipas kriterëve të përcaktuara me udhëzim të ministrit. Punonjësit arsimorë të institucioneve, që kanë nxënës me aftësi të kufizuara, certifikohen në programe trajnimi për trajtimin e këtyre nxënësve. 4. Njësia përkatëse bazë e qeverisjes vendore u siguron nxënësve me aftësi të kufizuara mjediset e përshtatshme të mësimdhënies e të të nxënës, sipas standardeve të përcaktuara nga ministria”.

Në mbështetje të këtij kuadri ligjor, Udhëzimi nr. 26, datë 25.11.2019 “Për mësuesin ndihmës për nxënësit me aftësi të kufizuara në institucionet publike të arsimit parauniversitar”, përcakton kriteret dhe procedurat për përzgjedhjen e mësuesit ndihmës. Nga përmbajtja e tij rezulton se, si rregull, mësuesi ndihmës duhet të jetë i profilit “arsim special”, ndërsa procedurat e përzgjedhjes së tij lidhen me procedurat e pranimit dhe emërimit në vend pune sipas kuadrit përkatës nënligjor.

Referuar Kreut X, neni 42, të Rregullores “Për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë”, miratuar nga MAS me Urdhërin Nr. 31, datë 28.01.2020, të ndryshuar, është parashikuar se: “1. Drejtori i IA-së është titullari i institucionit, që ka drejtën e firmës dhe të vulës së institucionit. 3. Drejtori ka përgjegjësi zbatimin në IA të kuadrit ligjor dhe nënligjor në fuqi..... 8. Drejtori merr masa për të siguruar ndjekjen e shkollës nga nxënësit e arsimit bazë, që i përkasin zonës së shkollës. Drejtori i IA-së publike të arsimit bazë me kohë të plotë bashkëpunon me NjMF-në, këshillin e prindërve të shkollës dhe këshillat e prindërve të klasave, qeverinë e nxënësve, me shërbimin psiko-social dhe me bordin e shkollës për të siguruar ndjekjen e shkollës nga nxënësit”.

Në nenin 75, Mungesat e nxënësve; Kreu II, Klasat IV-IX, pika 4, të Rregullores, përcaktohet se: “Kur nxënësi i klasave IV-IX mungon më shumë se 50% të orëve totale vjetore të planit mësimor, mbetet në klasë dhe përsërit vitin shkollor. Përfshihen nga ky rregull nxënësit me aftësi të kufizuara. Në këtë rast, vendimin e merr komisioni i IA-së për aftësinë e kufizuar”, ndërsa në nenin 76, pika 3, përcaktohet se: “Drejtori i IA-së së arsimit bazë njofton me shkresë titullarin e ZVA-së dhe personin që ushtron përgjegjësinë prindërore për nxënësin që i përket shkollës së tij dhe nuk

është regjistruar në shkollë, ose për nxënësin që mungon më shumë se 10 ditë mësimi, pa ndonjë arsye të vlefshme. Titullari i ZVA-së njofton me shkresë bashkinë, ku nxënësi banon, me të dhënat e paraqitura nga drejtori i IA-së”.

Në nenin 80 të saj Rregullorja ndër të tjera parashikon se: “...3. Komisioni, me kërkesën e personit që ushtron përgjegjësinë prindërore të fëmijës, ose drejtorit të IA-së, ku fëmija është regjistruar, vlerëson nevojat arsimore të fëmijës dhe ecurinë e tij. 4. Komisioni mbledhet tri herë në vit, para fillimit të vitit shkollor, në fund të periudhës së parë dhe në fund të vitit mësimor. 5. Drejtori i IA-së këshillohet me komisionin e institucionit, para se t’i drejtohet komisionit në ZVA, dhe bashkëpunon me personin që ushtron përgjegjësinë prindërore të fëmijës për të paraqitur kërkesën e tij. ... 7. Komisioni: a) njofton personin që ushtron përgjegjësinë prindërore për gjendjen dhe ecurinë e fëmijës; b) i jep me shkrim personit që ka paraqitur kërkesën rekomandimin për ndjekjen nga fëmija të shkollës së zakonshme ose të specializuar, ose kalimin nga shkolla e specializuar në shkollën e zakonshme apo anasjelltas; ...”.

Në nenin 81, pika 1, rregullorja e sipërcituar, parashikon se: “1. ZVA-ja siguron: a) arsimimin e fëmijëve me AK në një IA publik të zakonshëm ose të specializuar; b) arsimimin në shtëpi të nxënësve me AK që nuk mundën të ndjekin shkollë të zakonshme ose të specializuar të arsimit bazë. 2. Bazuar në rekomandimin e Komisionit Multidisiplinar, ZVA-ja cakton mësuesin ndihmës për fëmijët me AK sipas nevojave individuale të tyre”.

Ndërsa neni 83, i rregullores, përcakton në pikën 2 se: “2. Komisioni i IA-së së zakonshme, bazuar në vlerësimin e komisionit të ZVA-së: a) udhëzon mësuesit për hartimin e PEI-ve dhe i miraton ato; b) ndihmon mësuesit gjatë zbatimit të PEI-ve; c) ndjek ecurinë e fëmijëve AK; ç) paraqet në komisionin e ZVA-së raportin e ecurisë së nxënësit me AK, sipas formatit të vendosur nga komisioni i ZVA-së.”

Neni 88, i rregullores, ku përcaktohen të drejtat dhe detyrat e personave që ushtrojnë përgjegjësinë prindërore, specifikon në pikën 5 se: “Personat që ushtrojnë përgjegjësinë prindërore, vendosin nëse fëmija me AK, mbi të cilin ata ushtrojnë përgjegjësinë prindërore, do të ndjekë një institucion të specializuar ose të zakonshëm të arsimit bazë. Në IA-të e zakonshme hartimi i PEI për nxënësit me AK bëhet në bashkëpunim me personat që ushtrojnë përgjegjësinë prindërore të nxënësit. Ndryshimi i PEI brenda një IA-jë vendoset nga komisioni brenda institucionit, në bashkëpunim me personat që ushtrojnë përgjegjësinë prindërore të fëmijës.”

Udhëzuesi i rishikuar për praktikën e punës së Shërbimit Psiko-Social Shkollor, i miratuar në qershor 2025, përcakton se punonjësi i shërbimit psiko-social ka rol ndërmjetësues dhe lehtësues, bashkëpunon me mësuesit, prindërit dhe profesionistët e tjerë, ndihmon integrimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara, vlerëson nevojat psiko-emocionale dhe sociale të nxënësit dhe harton plane individuale ndërhyrjeje.

Udhëzuesi parashikon gjithashtu se komunikimi me prindin, ndërhyrjet individuale, ndarja e informacionit, miratimi i informuar, referimi dhe dokumentimi i rastit duhet të realizohen në

përputhje me standardet profesionale, etikën, konfidencialitetin dhe interesin më të lartë të fëmijës. Në pjesën që lidhet me aftësinë e kufizuar, parashikohet ngritja e komisionit të shkollës për aftësinë e kufizuar, vlerësimi periodik i ecures dhe hartimi i masave konkrete për integrimin dhe gjithëpërfshirjen e nxënësit.

A. Lidhur me trajtimin e padrejtë, të pafavorshëm dhe të pabarabartë të nxënësit D.D.M të përfaqësuar nga prindi znj. M.D.

Komisioneri, bazuar në objektin e ankesës, pretendimet e ankueses, prapësimet e paraqitura nga Shkolla “Niket Dardani”, qëndrimet e ZVAP Tiranë, dokumentacionin e administruar gjatë procedurës hetimore, si dhe shpjegimet e dhëna nga palët gjatë seancës dëgjimore, do të analizojë nëse nxënësi D.D.M, është ekspozuar ndaj një trajtimi të padrejtë, të pafavorshëm dhe të pabarabartë në kuptim të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010, “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar.

Analiza lidhet me tërësinë e pretendimeve që kanë të bëjnë me regjistrimin dhe përfshirjen e nxënësit në procesin mësimor, praninë e prindit në klasë, caktimin dhe veprimtarinë e mësueses ndihmëse, hartimin dhe zbatimin e Planit Edukativ Individual, veprimet e Shërbimit Psiko-Social Shkollor, kufizimin e qëndrimit të prindit në mjediset e klasës, mosfrekuentimin e nxënësit gjatë periudhave të caktuara, rikthimin e tij në procesin mësimor, mënyrën e testimit dhe vlerësimit, regjistrimin e të dhënave në SMIP, pasqyrimin e mungesave dhe lëshimin e dëftesës së përfundimit të klasës VI.

Lidhur me regjistrimin dhe përfshirjen fillestare të nxënësit në shkollë

Nga dokumentacioni rezulton se D.D.M është regjistruar për vitin shkollor 2025–2026 fillimisht në klasën VI-A sipas kriterit të gjuhës së huaj dhe më pas ka ndryshuar dhe ka kaluar në klasën VI-B të shkollës 9-vjeçare “Niket Dardani”. Nuk rezulton që shkolla të ketë refuzuar regjistrimin e tij për shkak të aftësisë së kufizuar ose të ketë vendosur kushte shtesë që nuk zbatoheshin për nxënësit e tjerë.

Përkundrazi, shkolla rezulton të ketë marrë dijeni për nevojat e tij dhe të ketë aktivizuar strukturat përkatëse. Sipas shpjegimeve të shkollës: - në datë 8 shtator nxënësi është regjistruar në klasë të VI-të; më 12.09.2025 është mbledhur komisioni i shkollës për aftësinë e kufizuar; në mungesë të mësueses ndihmëse është vendosur që prindi ta shoqëronte fëmijën përkohësisht; më 08.10.2025 është administruar rekomandimi i ZVAP-së për 12 orë mbështetje në javë; më 10.10.2025 është paraqitur mësuesja ndihmëse.

Këto rrethana tregojnë se institucioni nuk ka mbajtur një qëndrim mohues ndaj pranimi të nxënësit ose ndaj nevojës së tij për mbështetje. Lejimi fillestar i pranisë së nënës në klasë deri në sigurimin e mësueses ndihmëse përbën një masë të veçantë dhe të përkohshme, të marrë për të mundësuar vijimin e procesit mësimor.

Për rrjedhojë, në fazën e regjistrimit dhe të përfshirjes fillestare nuk rezulton një dallim, kufizim ose përjashtim që ta ketë vendosur nxënësin në pozitë më pak të favorshme se nxënësit e tjerë.

Lidhur me caktimin e mësueses ndihmëse dhe kundërshtimin e pranisë së saj

Ankuesja pretendon se mësuesja ndihmëse e caktuar nuk arriti të krijonte marrëdhënie besimi me fëmijën, se ai e refuzonte praninë e saj dhe se shkolla ushtroi presion të vazhdueshëm që fëmija ta pranonte. Sipas ankueses, institucioni nuk mori në konsideratë reagimet emocionale të fëmijës dhe dokumentacionin mjekësor që rekomandonte proces gradual përshtatjeje.

Nga ana tjetër, shkolla deklaroi se mësuesja ndihmëse u caktua nga ZVAP-ja, në bazë të vlerësimit të nevojave të nxënësit dhe rekomandimit për mbështetje. Pas paraqitjes së saj, prindit iu lejua të qëndronte edhe për një periudhë kalimtare, me qëllim atashimin gradual të fëmijës me mësuesen ndihmëse. Shkolla pretendon se kjo masë nuk funksionoi për shkak të refuzimit të vazhdueshëm të prindit dhe ndërhyrjeve të saj në proces.

Komisioneri vlerëson se mësuesi ndihmës është i parashikuar nga legjislacioni për të mbështetur nxënësin me aftësi të kufizuara gjatë procesit mësimor. Prindi ka të drejtë të informohet, të dëgjohet, të propozojë përmirësime dhe të bashkëpunojë në hartimin e masave mbështetëse, por nuk rezultoi se ka të drejtë të zgjedhë në mënyrë të njëanshme mësuesin ndihmës ose të kushtëzojë ndjekjen e mësimin me përjashtimin e mësuesit të caktuar nga institucioni kompetent.

Fakti që nxënësi ka shfaqur vështirësi në krijimin e marrëdhënies me mësuesen ndihmëse kërkonte kujdes, fleksibilitet dhe ndërhyrje graduale. Megjithatë, vetëm kjo rrethanë nuk provon se caktimi i mësueses ndihmëse ose këmbëngulja e shkollës për aktivizimin e saj përbënin trajtim të pafavorshëm për shkak të aftësisë së kufizuar. Përkundrazi, caktimi i saj ishte një masë e drejtpërdrejtë mbështetëse, e lidhur pikërisht me nevojat e nxënësit.

Nga aktet rezultoi se institucioni lejoi praninë e përkohshme të prindit, organizoi takime, caktoi periudhë tranzicioni dhe, më pas, më 18.02.2026, ndryshoi ngarkesën mësimore, duke caktuar si mësuese ndihmëse një mësuese të diplomuar në pedagogji speciale.

Këto veprime nuk përputhen me një qëndrim përjashtues ose refuzues ndaj nevojës së nxënësit për mbështetje. Megjithatë, vlerësohet se disa nga këto masa, veçanërisht caktimi i një mësuesi ndihmës me formimin përkatës në pedagogji speciale, janë ndërmarrë në një fazë të mëvonshme. Për këtë arsye, edhe pse masat e marra duhen vlerësuar pozitivisht, mund të ishte ndërhyrë më herët dhe në mënyrë më të përshtatshme me nevojat konkrete të nxënësit.

Lidhur me praninë e prindit në klasë dhe kufizimin e kësaj pranie

Komisioneri vlerëson se pretendimet e palëve lidhur me praninë e znj. M.D në klasën ku zhvillonte mësimin djali i saj, D.D.M, duhet të shqyrtohen duke mbajtur në konsideratë, nga njëra anë, të drejtën dhe përgjegjësinë e prindit për t'u përfshirë në arsimimin e fëmijës dhe nga ana tjetër, kompetencën e drejtuesit të institucionit arsimor për të organizuar, drejtuar dhe garantuar zhvillimin normal, të sigurt dhe të pandërprerë të procesit mësimor.

Ankuesja ka pretenduar se prania e saj në klasë nuk ishte prani e zakonshme e një prindi vëzhgues dhe as ndërhyrje në kompetencat e mësuesve. Sipas saj, ajo qëndronte pranë fëmijës për shkak të

vështirësive të tij zhvillimore, ankthit, vështirësisë për t'u përshtatur në një shkollë të re dhe refuzimit të menjëhershëm të mësueses ndihmëse të caktuar.

Sipas ankueses, fakti që shkolla e lejoi praninë e saj nga fillimi i vitit shkollor deri në muajin nëntor 2025 tregon se institucioni e kishte njohur fillimisht këtë prani si një masë të nevojshme. Ajo pretendon se ndërprerja e menjëhershme e kësaj mase, pa një plan tranzicioni të dakordësuar dhe pa u provuar se fëmija ishte përshtatur me mësuesen ndihmëse, cenoi interesin më të lartë të fëmijës dhe solli ndërprerjen e frekuentimit të mësimi.

Shkolla ka prapësuar se prania e ankueses në klasë ishte lejuar vetëm përkohësisht, deri në sigurimin e mësueses ndihmëse dhe gjatë një periudhe fillestare përshtatjeje.

Sipas institucionit, pas caktimit të mësueses ndihmëse, prania e vazhdueshme e prindit: pengonte krijimin e marrëdhënies profesionale ndërmjet nxënësit dhe mësueses ndihmëse; krijonte varësi të vazhdueshme të nxënësit nga prindi; ndikonte në zhvillimin normal të orëve; cenonte autoritetin dhe lirinë profesionale të mësuesve; shkaktonte shqetësim të nxënësit e tjerë dhe prindërit e tyre; krijonte tensione dhe ndërhyrje në procesin pedagogjik.

Në dokumentacion janë administruar kërkesa dhe peticione të prindërve të klasës VI-B, të Këshillit të Prindërve dhe të mësuesve, në të cilat kërkohej largimi i ankueses nga klasa, jo për shkak të statusit të fëmijës, por për shkak të pretendimeve për ndërhyrje në procesin mësimor dhe ndikim në klimën e klasës.

Me shkresën nr. 3003/1, datë 11.12.2025, AKAP i kërkoi drejtueses së shkollës marrjen e masave për moscenimin e procesit mësimor dhe përcaktoi se ankuesja nuk duhej të qëndronte në klasë gjatë orëve të mësimi, ndërsa nxënësi duhej të asistohet nga mësuesja ndihmëse në bashkëpunim me mësuesit lëndorë.

Komisioneri çmon se ligji nr. 69/2012 dhe Rregullorja nuk parashikojnë një të drejtë të përgjithshme dhe të pakushtëzuar të prindit për të qëndruar në klasë gjatë zhvillimit të procesit mësimor.

Prindi ka të drejtë të jetë partner i institucionit, të informohet, të dëgjohet, të paraqesë kërkesa, të propozojë masa dhe të marrë pjesë në hartimin dhe vlerësimin e PEI-së. Megjithatë, ushtrimi i këtyre të drejtave realizohet përmes takimeve, komisioneve, komunikimeve institucionale dhe procedurave të parashikuara dhe jo domosdoshmërisht përmes pranisë së vazhdueshme fizike në klasë. Çdo vendimmarrje lidhur me mënyrën e mbështetjes së fëmijës duhet të udhëhiqet nga interesi më i lartë i fëmijës dhe të bazohet në një vlerësim të plotë, individual dhe multidisiplinor të nevojave të tij, duke marrë në konsideratë edhe mendimin dhe informacionin e dhënë nga prindi.

Klasa është mjedisi ku zhvillohet procesi pedagogjik nën përgjegjësinë profesionale të mësuesit dhe nën autoritetin administrativ të drejtuesit të institucionit. Drejtori ka detyrimin të garantojë jo vetëm të drejtat e një nxënësi, por edhe: të drejtën e nxënësve të tjerë për mësim në kushte të qeta; sigurinë dhe disiplinën në institucion; lirinë profesionale të mësuesit; respektimin e privatësisë dhe

të dhënave të nxënësve të tjerë; zbatimin e rregullores së brendshme; funksionimin normal dhe të pandërprerë të procesit mësimor.

Për këtë arsye, drejtuesi ka kompetencë të rregullojë hyrjen dhe qëndrimin e prindërve në mjediset e brendshme të shkollës dhe veçanërisht, në klasë. Kjo kompetencë nuk mund të ushtrohet në mënyrë arbitrare, por duhet të mbështetet në rrethana konkrete, të ndjekë një qëllim të ligjshëm dhe të respektojë parimin e proporcionalitetit. Rregullimi i hyrjes dhe qëndrimit të personave të tretë në klasë është pjesë e përgjegjësisë së institucionit arsimor për sigurinë, disiplinën dhe zhvillimin normal të mësimi. Shkolla duhet të marrë në konsideratë interesin e fëmijës me aftësi të kufizuara, por njëkohësisht duhet të mbrojë të drejtën për arsimim, privatësinë dhe mirëqenien e nxënësve të tjerë.

Në rastin e një nxënësi me aftësi të kufizuara, prania e përkohshme e prindit mund të përdoret si masë tranzitore, kur, bazuar në vlerësimin e strukturave të shkollës, çmohet se ajo është e nevojshme dhe në interesin më të lartë të fëmijës, veçanërisht për të lehtësuar përshtatjen dhe integrimin gradual të tij në mjedisin shkollor. Nevoja, kohëzgjatja dhe mënyra e zbatimit të kësaj mase duhet të vlerësohen në mënyrë individuale, në varësi të nivelit të përshtatjes së fëmijës, nevojave të tij konkrete dhe ecurisë së procesit të integrit, me mundësinë e rishikimit të saj nga strukturat përgjegjëse.

Në këtë vlerësim duhet të merret në konsideratë edhe roli që mund të ketë prindi në mbështetjen e fëmijës, jo vetëm në cilësinë e prindit, por edhe në rastet kur ai ushtron rolin e shoqëruesit të fëmijës, sipas parashikimeve të kuadrit ligjor dhe nënligjor përkatës. Për rrjedhojë, prania e prindit/shoqëruesit mund të jetë një masë e përshtatshme mbështetëse në rrethana të caktuara, por nevoja për të dhe mënyra e ushtrimit të saj duhet të përcaktohen mbi bazën e vlerësimit individual të fëmijës dhe jo të konsiderohet automatikisht si një e drejtë e pakufizuar ose e përhershme për praninë fizike të prindit në klasë.

Një prani e tillë duhet: të mbështetet në një vlerësim konkret të nevojës së fëmijës; të përcaktohet nga komisioni për nxënësit me aftësi të kufizuara, në bashkëpunim me prindin dhe profesionistët; të ketë qëllim, afat dhe mënyrë zbatimi të përcaktuar; të përfshihet, kur është e nevojshme, në planin individual të ndërhyrjes ose në masat e lidhura me PEI-në; të rishikohet periodikisht sipas ecurisë së nxënësit; të mos cenojë procesin mësimor, privatësinë dhe të drejtat e nxënësve të tjerë.

Ankuesja nuk mund ta kushtëzonte në mënyrë të njëanshme frekuentimin e fëmijës me praninë e saj të përhershme në klasë ose me përjashtimin e mësueses ndihmëse të caktuar nga institucionet kompetente. Detyrimi i saj ligjor ishte të bashkëpunonte me komisionin, drejtuesin, mësuesit dhe mësuesen ndihmëse për të gjetur një zgjidhje që siguronte vazhdimësinë e procesit mësimor.

E drejta për të propozuar përmirësime ose për të kundërshtuar një masë nuk përfshin të drejtën për të marrë në mënyrë të njëanshme vendime pedagogjike apo organizative. Po kështu, e drejta për të mbështetur fëmijën nuk përfshin të drejtën për të ndërhyrë në zhvillimin e orës, në vlerësimin e nxënësit, në komunikimin e mësuesit me klasën ose në të drejtat e nxënësve të tjerë.

Në kushtet e rastit konkret, prindi nuk mund të kushtëzonte në mënyrë të njëanshme vijimin e frekuentimit të fëmijës me praninë e saj të përhershme në klasë ose me mospranimin e mësueses ndihmëse. Nëse prindi vlerësonte se mësuesja ndihmëse e caktuar nuk përmbushte kriteret ose nuk ishte e përshtatshme për të ofruar mbështetjen e nevojshme për fëmijën e saj, ajo kishte të drejtën të paraqiste kërkesat, kundërshtimet ose ankesat përkatëse pranë strukturave kompetente dhe të kërkonte rishikimin e masës së marrë.

Megjithatë, këto kundërshtime duhej të adresoheshin përmes mekanizmave institucionalë dhe nuk mund të shërbenin si pengesë për vijimin e arsimimit të fëmijës. Në çdo rast, si prindi, ashtu edhe institucionet arsimore duhet të bashkëpunojnë me komisionin, drejtuesin, mësuesit dhe mësuesin ndihmës për të gjetur zgjidhjen më të përshtatshme, duke pasur në qendër interesin më të lartë të fëmijës, nevojat e tij individuale dhe garantimin e vazhdimësisë së procesit arsimor.

Nga dokumentacioni rezulton se kufizimi nuk është vendosur që në fillim, por pas një periudhe kur prania e prindit ishte toleruar, pas caktimit të mësueses ndihmëse dhe pas paraqitjes së shqetësimeve nga mësuesit dhe prindërit e tjerë. Kjo rrethanë tregon se vendimi nuk është marrë vetëm për shkak të statusit të ankueses si prind ose aftësisë së kufizuar të fëmijës.

Në rastin konkret, fakti që shkolla lejoi fillimisht praninë e prindit, aktivizoi komisionin për nxënësit me aftësi të kufizuara dhe, më pas, caktoi një mësuese ndihmëse, tregon se institucioni ka ndërmarrë masa për të adresuar nevojat e nxënësit. Për rrjedhojë, kufizimi i mëvonshëm i pranisë së ankueses në klasë, i parë në vetvete dhe në kushtet kur vijonte të ofrohej mbështetje profesionale për nxënësin, nuk mund të konsiderohet automatikisht si masë përjashtuese.

Megjithatë, kjo nuk e përjashton përgjegjësinë e institucionit arsimor për të siguruar që masat mbështetëse të jenë të përshtatshme, efektive dhe të ndërmerren në kohën e duhur. Në rastin konkret, caktimi i një mësueseje ndihmëse me formimin përkatës në pedagogji speciale është realizuar vetëm në një fazë të mëvonshme, çka tregon se shkolla kishte mundësi të ndërmernte më herët masa më të përshtatura me nevojat konkrete të nxënësit. Për këtë arsye, vlerësohet se përgjegjësia e institucionit nuk lidhet vetëm me marrjen e një mase, por edhe me kohën, përshtatshmërinë dhe efektivitetin e saj.

Kufizimi i pranisë së vazhdueshme të prindit në klasë, në parim, mund të justifikohet me nevojën për funksionimin normal të procesit mësimor dhe me interesin e të gjithë nxënësve, për sa kohë që nxënësit me aftësi të kufizuara i sigurohen masat e nevojshme dhe të përshtatura të mbështetjes. Në këtë kuptim, masa e marrë nga shkolla nuk rezulton të ketë pasur si qëllim përjashtimin e nxënësit nga arsimi, pasi institucioni ka vijuar të kërkojë frekuentimin e tij dhe ka ndërmarrë hapa për sigurimin e mbështetjes përkatëse.

Megjithatë, shkolla kishte detyrimin që, paralelisht me rregullimin e pranisë së prindit në klasë, të garantonte në kohë një alternativë reale dhe efektive mbështetëse për fëmijën. Prandaj, vonesa në sigurimin e mësueses ndihmëse me formimin e përshtatshëm, si dhe nevoja për një vlerësim më të

plotë të nevojave individuale të nxënësit, përbëjnë elemente që duhet të mbahen në konsideratë në vlerësimin e veprimeve të institucionit.

Në këto kushte, Komisioneri vlerëson se kufizimi i qëndrimit të prindit në klasë, i marrë veçmas, nuk provon trajtim të padrejtë dhe të pabarabartë për shkak të përgjegjësisë prindërore dhe as diskriminim për shkak të shoqërimit me një person me aftësi të kufizuara. Megjithatë, mënyra dhe koha në të cilën shkolla ka organizuar mbështetjen për nxënësin tregojnë se institucioni mund dhe duhet të kishte ndërmarrë më herët masa më të përshtatura, në mënyrë që kufizimi i pranisë së prindit të shoqërohej që në fillim me mbështetjen e nevojshme profesionale dhe të mos krijonte vështirësi të panevojshme në vijimin e procesit arsimor të fëmijës.

Lidhur me pretendimet për presion, komunikim të papërshtatshëm dhe veprimet e Shërbimit Psiko-Social

Ankuesja ka pretenduar se punonjëset e Shërbimit Psiko-Social, nëndrejtoresha dhe mësuesja ndihmëse kanë ushtruar presion ndaj fëmijës, kanë ndërhyrë në klasë, kanë komunikuar në mënyrë fyese dhe kanë kërkuar dorëzimin e telefonit ose kontrollin e sendeve personale.

Pretendimet lidhen, ndër të tjera, me ngjarjet e datave 29.10.2025 dhe 31.10.2025, për të cilat ankuesja ka kërkuar administrimin e pamjeve të kamerave të sigurisë.

Shkolla i ka kundërshtuar këto pretendime dhe ka deklaruar se punonjësit e saj kanë vepruar në përmbushje të detyrave profesionale. Kërkesa për dorëzimin e telefonit, sipas shkollës, ishte një procedurë e dakordësuar dhe e dokumentuar, ndërsa ndërhyrjet e Shërbimit Psiko-Social kishin për qëllim menaxhimin e situatës dhe përshtatjen e nxënësit me mësuesen ndihmëse.

Udhëzuesi për Shërbimin Psiko-Social përcakton se punonjësi duhet të bashkëpunojë me prindin, të lehtësojë marrëdhëniet dhe të veprojë në interes të fëmijës, duke respektuar etikën dhe konfidencialitetin.

Nga provat e administruara nuk rezulton të jetë dokumentuar në mënyrë objektive përdorimi i shprehjeve fyese apo i një gjuhe që lidhet me aftësinë e kufizuar të nxënësit ose me statusin prindëror të ankueses. Nuk janë administruar deklarime të pavarura apo procesverbale që të provojnë përmbajtjen diskriminuese të komunikimit.

Po kështu, ndërhyrja e Shërbimit Psiko-Social në situatën e një nxënësi me vështirësi të dokumentuara, në vetvete, nuk përbën trajtim të pabarabartë, pasi ky shërbim ka detyrimin të vlerësojë, të ndërhyjë dhe të bashkëpunojë me strukturat e tjera.

Komisioneri evidenton se mënyra e komunikimit mund të ishte administruar me më shumë kujdes, duke shmangur përballjet në prani të fëmijës dhe të nxënësve të tjerë. Megjithatë, mangësitë në komunikimin institucional nuk përbëjnë diskriminim pa u provuar lidhja e tyre me një shkak të mbrojtur.

Lidhur me raportimin e fëmijës pranë strukturave të mbrojtjes

Shërbimi Psiko-Social i shkollës plotësoi formularin e raportimit të fëmijës në nevojë për mbrojtje, duke evidentuar vështirësi në socializim, refuzim të mësueses mbështetëse dhe ndikim të sjelljes së prindit në procesin arsimor.

Ankuesja e ka konsideruar këtë raportim të pasaktë, stigmatizues dhe të përdorur si mjet presioni ndaj saj. Ajo e ka kundërshtuar zyrtarisht përmbajtjen e tij më 09.03.2026.

Sipas Udhëzuesit të Shërbimit Psiko-Social, referimi për mbrojtje është një instrument që përdoret kur punonjësi vlerëson se ekzistojnë rrethana që mund të cenojnë mirëqenien ose zhvillimin e fëmijës. Udhëzuesi përmban një model të posaçëm të formularit të raportimit dhe kërkon dokumentimin e rrethanave të vlerësuara.

Komisioneri vlerëson se raportimi pranë strukturës së mbrojtjes së fëmijës, në vetvete, nuk është masë ndëshkuese dhe as provë e diskriminimit. Ai aktivizon mekanizmin ndërinstitucional të vlerësimit dhe nuk vendos përfundimisht se prindi ka kryer neglizhencë.

Në dosje nuk rezulton se shkolla ka përdorur në formular shprehje denigruese të lidhura me një shkak të mbrojtur. Raportimi është motivuar nga perceptimi i shkollës për mosfrekuentimin, vështirësitë e bashkëpunimit dhe ndikimin e konfliktit në gjendjen e fëmijës.

Megjithatë, Komisioneri vlerëson se institucioni arsimor duhet të tregojë kujdes të veçantë në hartimin e raporteve të tilla, duke garantuar që çdo konstatim të jetë i mbështetur në fakte të verifikueshme, i formuluar në mënyrë objektive dhe profesionale dhe të kufizohet në rrethanat që lidhen drejtpërdrejt me mirëqenien dhe interesin më të lartë të fëmijës. Vlerësime që lidhen me sjelljen e prindit duhet të paraqiten me kujdes dhe pa përdorur formulime që mund të perceptohen si stigmatizuese ose fajësuese, veçanërisht në kushtet e një konflikti të mëparshëm ndërmjet prindit dhe institucionit.

Gjithashtu, përpara referimit dhe gjatë dokumentimit të situatës, shkolla duhet të sigurojë që të jenë evidentuar qartë rrethanat konkrete, masat e ndërmarra për adresimin e tyre dhe përpjekjet për bashkëpunim me prindin, në mënyrë që raportimi të shërbejë realisht për vlerësimin dhe mbrojtjen e fëmijës dhe jo të perceptohet si instrument presioni në një mosmarrëveshje institucionale.

Për rrjedhojë, Komisioneri vlerëson se vetë raportimi pranë strukturave të mbrojtjes së fëmijës nuk provohet të ketë përbërë trajtim të padrejtë ose të pabarabartë në kuptim të ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar. Megjithatë, mënyra e formulimit dhe dokumentimit të konstatimeve duhet të jetë objektive, e kujdesshme dhe e bazuar në evidencë, në mënyrë që të shmanget çdo perceptim stigmatizues ndaj prindit dhe të garantohet që veprimet e institucionit të udhëhiqen në çdo rast nga interesi më i lartë i fëmijës.

Lidhur me periudhat e mosfrekuentimit të nxënësit

Ankuesja pretendon se fëmija u la jashtë shkollës për një periudhë të gjatë dhe se shkolla i mbylli derën, duke i mohuar aksesin në procesin mësimor.

Shkolla pretendon se nxënësit nuk iu mohua e drejta për të ndjekur mësimin. Sipas shkollës nxënësi mund të frekuentonte klasën me mbështetjen e mësueses ndihmëse, por prindi e kushtëzonte frekuentimin me praninë e saj në klasë.

Dokumentacioni tregon se fëmija nuk ka frekuentuar rregullisht gjatë një periudhe të konsiderueshme. Megjithatë, për të vlerësuar nëse kjo periudhë përbën trajtim diskriminues, duhet të përcaktohet nëse shkolla: refuzoi hyrjen e vetë nxënësit; anuloi regjistrimin e tij; refuzoi t'i ofronte mësues ndihmës; vendosi një kusht të lidhur me aftësinë e kufizuar; ose, në të kundërt, kërkoi që fëmija të vijonte mësimin pa praninë e vazhdueshme të prindit.

Nga dokumentet e administruara rezulton se qëndrimi institucional ishte që nxënësi të frekuentonte procesin mësimor dhe të asistohet nga mësuesja ndihmëse. Udhëzimet e ZVAP-së dhe AKAP-së nuk parashikonin përjashtimin e nxënësit, por moslejimin e prindit në klasë.

Kështu, mosfrekuentimi ka ardhur në kontekstin e një mosmarrëveshjeje për modalitetin e mbështetjes dhe praninë e nënës dhe jo nga një akt që i ndalonte nxënësit të ndiqte mësimin për shkak të aftësisë së kufizuar.

Komisioneri vlerëson se institucioni duhet të vijonte kërkimin e alternativave të zbatueshme dhe të dokumentonte më qartë ofertën konkrete arsimore gjatë kësaj periudhe. Megjithatë, provat nuk tregojnë se shkolla kishte si qëllim ose pasojë të domosdoshme përjashtimin e nxënësit nga mësimi.

Më 06–07.05.2026, nxënësi u rikthye në shkollë dhe sipas shkresës nr. 165, datë 18.06.2026, frekuentoi rregullisht deri në përfundim të vitit shkollor, duke u shoqëruar çdo ditë nga prindi dhe duke marrë mbështetje nga mësuesja ndihmëse, mësuesit dhe Shërbimi Psiko-Social.

Rikthimi, vijimi i mësimin dhe përfundimi i klasës VI tregojnë se shkolla nuk ka ndjekur një politikë të përjashtimit të nxënësit nga sistemi arsimor.

Megjithatë, Komisioneri vlerëson se përgjegjësia e institucionit arsimor nuk përfundon me përcaktimin se nxënësi mund të frekuentojë mësimin. Në rrethanat e një fëmije me aftësi të kufizuara, shkolla duhet të ndërmarrë në mënyrë aktive të gjitha masat e arsyeshme dhe të përshtatshme për të garantuar aksesin dhe vijimin efektiv të arsimit, duke marrë në konsideratë nevojat individuale të fëmijës dhe duke bashkëpunuar me prindin dhe strukturat profesionale. Në këtë rast, shkolla duhet të vijonte kërkimin e alternativave të zbatueshme dhe të dokumentonte në mënyrë më të plotë masat konkrete të ndërmarra për të mundësuar rikthimin e fëmijës në procesin mësimor gjatë periudhës së mosfrekuentimit.

Në këto rrethana, Komisioneri nuk konstaton diskriminim në kuptim të ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, por vlerëson se mënyra e menaxhimit të situatës nga institucioni arsimor duhet të shërbejë si një rast për përmirësimin e reagimit institucional në raste të ngjashme, veçanërisht në drejtim të ndërhyrjes në kohë, vlerësimit individual të nevojave të nxënësit dhe sigurimit të masave të përshtatshme të mbështetjes, me qëllim që asnjë mosmarrëveshje ndërmjet prindit dhe institucionit të mos ndikojë në vijimin e arsimimit të fëmijës.

Lidhur me PEI-n dhe pretendimin për mohim të përshtatjes së arsyeshme

Ankuesja pretendon se PEI-ja nuk është hartuar në bashkëpunim real me të, se përmbante objektiva të përgjithshme, të gjera dhe jo të individualizuara dhe se për dy periudhat e para nuk ekzistonte një PEI i dakordësuar si dhe ka kërkuar qëndrimin e saj në klasë si masë përshtatjeje të arsyeshme.

Ajo pretendon gjithashtu se objektivat e PEI-së nuk u zbatuan siç duhet gjatë testimit dhe se fëmija u vlerësua mbi njohuri që nuk i ishin shpjeguar gjatë periudhës së munguar.

Shkolla deklaron se PEI është hartuar nga komisioni përkatës, në bazë të rekomandimeve të Komisionit Multidisiplinar dhe se ankuesja ka kundërshtuar, refuzuar ose ka vonuar firmosjen e tij. Shkolla ka paraqitur dokumentacion për mbledhjet e komisionit, objektivat e përcaktuara dhe materialet e punës.

Në kuptim të rregullores së institucioneve arsimore dhe Udhëzuesit të Shërbimit Psiko-Social, prindi është pjesëmarrës i rëndësishëm në procesin e hartimit dhe rishikimit të PEI-së. Pjesëmarrja e tij është veçanërisht e nevojshme për identifikimin e nevojave, përcaktimin e objektivave dhe vlerësimin e progresit.

Megjithatë, e drejta e prindit për të marrë pjesë dhe për të propozuar përmirësime nuk i jep atij të drejtë mbi çdo element pedagogjik, as nuk e bën PEI-n juridikisht të pavlefshme vetëm për shkak të mungesës së firmës së tij, nëse institucioni provon se ka kërkuar bashkëpunim dhe ka hartuar planin nëpërmjet komisionit profesional. Në rast mosdakordësie, vendimmarrja për përmbajtjen dhe masat pedagogjike duhet të mbështetet në vlerësimin profesional të strukturave përgjegjëse, por ky proces duhet të jetë transparent, i arsyetuar dhe i dokumentuar, duke i dhënë prindit mundësi reale për të paraqitur dhe diskutuar pikëpamjet e tij.

Me datë 21.10.2025 nga komisioni i shkollës për nxënësit me AK është hartuar plani individual 10 ditor për nxënësin, plan për të cilin ankuesja nuk ka qenë dakord.

Rezulton se komisioni shkollor për nxënësit me AK ka hartuar planin PEI për periudhën tetor-dhjetor 2025 për nxënësin D.D.M, plan i cili është firmosur edhe nga të gjithë mësuesit lëndorë.

Rezulton se përpara datës 21.01.2026, komisioni shkollor për nxënësit me AK ka hartuar draft planin PEI për periudhën janar-mars 2026 për të cilin ankuesja ka shprehur mosdakordësinë e saj. Më pas komisioni ka hartuar planin PEI për periudhën janar-mars 2026.

Rezulton se nga ana e komisionit shkollor për nxënësit me AK është hartuar plani PEI për periudhën prill-qershor për nxënësin D.D.M, plan i cili është firmosur edhe nga të gjithë mësuesit lëndorë.

Nga provat rezulton se ndërmjet palëve ka pasur mosdakordësi të vazhdueshme për përmbajtjen dhe mënyrën e zbatimit të PEI-së. Megjithatë, nuk rezulton se shkolla ka refuzuar në parim hartimin e një plani të individualizuar ose ka zbatuar me vetëdije programin standard pa asnjë përshtatje. Në këtë drejtim, shkolla duhej të kishte bërë përpjekje më të qarta për të dokumentuar përfshirjen e prindit, shqyrtimin e vërejtjeve të tij dhe arsyetimin profesional për pranimin ose mospranimin e propozimeve të bëra prej tij.

Dokumentet e testimit, projektet, objektivat dhe komunikimet e mësuesve tregojnë se nxënësi është vlerësuar në forma të ndryshme dhe se janë marrë në konsideratë detyrat, pjesëmarrja, projektet dhe progresi.

Rezulton se shkolla ka marrë masa rregulluese që ankuesja për një periudhë kohe të qëndrojë me djalin në klasë derisa ai të përshtatej me mësuesen ndihmëse. Rezulton gjithashtu se në shkollë janë të regjistruar 19 nxënës me aftësi të kufizuara për të cilët nuk rezulton se shkolla ka lejuar që ato të shoqërohen nga prindërit. Kjo masë e përkohshme është lejuar vetëm për ankuesen si masë përshtatjeje e përkohshme.

Duke pasur parasysh se përshtatja e arsyeshme kërkon një vlerësim individual të nevojave të personit me aftësi të kufizuara, shkolla duhej të kishte dokumentuar më qartë arsyet profesionale për të cilat prania e përkohshme e prindit konsiderohej e mjaftueshme dhe arsyet për të cilat, pas një periudhe të caktuar, ajo nuk konsiderohej më e nevojshme. Ky vlerësim duhej të mbështetej në konstatimet e ekipit multidisiplinor dhe në ecurinë konkrete të përshtatjes së fëmijës.

Mangësitë e pretenduara në formulimin e objektiveve ose mospërputhjet ndërmjet PEI-së dhe testeve janë çështje që mund të kërkojnë vlerësim pedagogjik dhe inspektim arsimor. Por, për të përbërë mohim të përshtatjes së arsyeshme, duhet të provohet se institucioni ka refuzuar një përshtatje të domosdoshme, të përshtatshme dhe të mundshme, pa një justifikim objektiv.

Në rastin konkret, shkolla ka ofruar: mësuese ndihmëse; periudhë të përkohshme të pranisë së prindit; PEI; mbështetje psiko-sociale; materiale dhe forma të ndryshme vlerësimi; ndryshim të mësueses ndihmëse; rikthim dhe frekuentim deri në përfundimin e vitit; vlerësim dhe pajisje me dëftesë.

Për rrjedhojë, në bazë të provave të administruara, nuk rezulton se shkolla ka mohuar në mënyrë të përgjithshme ose të qëllimshme përshtatjen e arsyeshme për shkak të aftësisë së kufizuar. Komisioneri vlerëson se institucioni arsimor duhet të përmirësojë mënyrën e dokumentimit dhe të zbatimit të procesit të PEI-së, veçanërisht sa i përket përfshirjes reale të prindit, individualizimit të objektiveve, arsyetimit të masave të përshtatjes dhe lidhjes ndërmjet objektiveve të PEI-së dhe mënyrës së vlerësimit të nxënësit.

Në këtë kuptim, mangësitë e evidentuara nuk janë të mjaftueshme, në rrethanat e këtij rasti, për të konkluduar ekzistencën e diskriminimit, por përbëjnë elemente që institucioni arsimor duhet t'i adresojë në vijim, në mënyrë që procesi i arsimit gjithëpërfshirës dhe përshtatja e arsyeshme të mos mbeten vetëm në nivel formal, por të sigurojnë në praktikë mbështetjen më të përshtatshme për nevojat individuale të nxënësit.

Lidhur me testimin, notat dhe vlerësimin përfundimtar

Ankuesja ka kundërshtuar mënyrën e vlerësimit, duke pretenduar se: fëmija është pyetur për tema që nuk i kishte zhvilluar; testet nuk ishin të përshtatura; objektivat e testimit ishin standarde dhe jo individuale; disa nota janë regjistruar me vonesë në SMIP; rezultatet e punimeve ishin më të larta

se notat; notat përfundimtare nuk pasqyrojnë progresin; materialet e testimit nuk iu vunë në dispozicion.

Me email-in e datës 15.05.2026, ankuesja kundërshtoi pyetjen e fëmijës për tema të patrajtuara gjatë mungesës. Më 12 dhe 16.06.2026 kërkoi verifikimin e mënyrës së vlerësimit dhe argumentoi se objektivat e PEI-së ishin arritur ose tejkaluar.

Shkolla, me shkresën nr. 168 prot., datë 22.06.2026, ka deklaruar se monitoroi të dhënat në SMIP dhe zhvilloi takime me mësuesit lëndorë. Në këtë shkresë jepen shpjegime konkrete për vlerësime në lëndë të ndryshme, përfshirë lëndën e historisë, dhe argumentohet se notat u mbështetën në detyrat e klasës, përgjigjet, projektet dhe pjesëmarrjen e nxënësit.

Komisioneri nuk zëvendëson organet pedagogjike në përcaktimin e një note konkrete, përveçse kur procesi i vlerësimit rezulton haptazi arbitrar dhe i lidhur me një shkak të mbrojtur.

Në rastin konkret, ankuesja ka paraqitur elemente që ngrenë dyshime për kohën e regjistrimit të disa notave, përputhjen e testeve me PEI-në dhe transparencën e procesit. Megjithatë, nuk është provuar se: nxënësi e tjerë në të njëjtat rrethana janë vlerësuar sipas standardeve më të favorshme; notat janë ulur për shkak të aftësisë së kufizuar; mësuesit kanë përdorur kritere denigruese ose të lidhura me diagnozën; ka pasur një udhëzim institucional për penalizimin e nxënësit; rezultatet e fëmijës janë ndryshuar qëllimisht për shkak të ankesave të nënës.

Shkolla ka paraqitur shpjegime pedagogjike për vlerësimet dhe ka provuar se nxënësi është vlerësuar edhe me nota të larta. Dëftesa përmban kryesisht nota 9 dhe 10 në disa lëndë, çka nuk mbështet pretendimin për një politikë të përgjithshme të uljes së vlerësimit për shkak të aftësisë së kufizuar.

Çështja e regjistrimit të vonuar të një note në SMIP nuk provon vetvetiu se nota është e rreme ose diskriminuese. Po kështu, mospajtimi i prindit me vlerësimin e një testi nuk është i mjaftueshëm për të provuar trajtim të pabarabartë pa një krahasim objektiv dhe pa një lidhje me shkakun e mbrojtur.

Për rrjedhojë, Komisioneri nuk konstaton se procesi i vlerësimit, në tërësinë e tij, e ka vendosur nxënësin në një pozitë më pak të favorshme për shkak të aftësisë së kufizuar.

Lidhur me pasqyrimin e mungesave dhe lëshimin e dëftesës

Ankuesja është njoftuar më 20.07.2026, nëpërmjet portalit e-Albania, për dëftesën e fëmijës. Ajo ka kundërshtuar mungesat e pasqyruara dhe shënimin se vlerësimi është bërë mbi bazën e PEI-së.

Sipas saj, mungesat nuk kanë ardhur për faj të fëmijës ose nga neglizhenca prindërore, por nga veprimet e institucionit. Ajo ka kërkuar gjithashtu sqarim se si është deklaruar vlerësimi sipas PEI-së për të gjithë vitin, kur sipas saj PEI-ja e dakordësuar është zbatuar vetëm gjatë periudhës së fundit.

Rregullorja e ndryshuar me urdhrin nr. 300, datë 19.06.2024, përcakton se regjistri, amza dhe dëftesa digjitale plotësohen dhe gjenerohen nëpërmjet SMIP-it dhe portalit e-Albania.

VKM nr. 742, datë 03.12.2021, përcakton SMIP-in si bazë shtetërore të të dhënave, institucionet dhënëse të informacionit dhe rolet e aksesit, duke përfshirë administratorin e shkollës, i cili gjeneron dëftesa dhe certifikata.

Pasqyrimi i mungesave në dëftesë është një veprim administrativ që duhet të mbështetet në regjistrin e frekuentimit. Nëse mungesat janë kategorizuar gabimisht ose nuk pasqyrojnë shkaqet reale të mosfrekuentimit, kjo mund të kërkojë korrigjim administrativ.

Megjithatë, vetëm pasqyrimi numerik i mungesave nuk përbën diskriminim, nëse sistemi ka regjistruar faktin objektiv se nxënësi nuk ka qenë i pranishëm në mësim.

Në dëftesë nuk rezulton se mungesat janë cilësuar si pasojë e diagnozës, e sjelljes së fëmijës ose e neglizhencës së prindit. Po kështu, nxënësi është vlerësuar, ka përfunduar klasën VI dhe është pajisur me dëftesë.

Për këtë arsye, mospajtimi për arsyen ose kategorizimin e mungesave mund të jetë objekt i verifikimit administrativ, por nuk provon se fëmija është vendosur në pozitë të pafavorshme për shkak të aftësisë së kufizuar.

Për sa më sipër, Komisioneri vlerëson se shkolla ka zbatuar legjislacionin e sipërcituar, i detyrueshëm për institucionet arsimore duke kryer veprimet si më poshtë: nxënësi është regjistruar dhe pranuar në shkollë pa pengesa të lidhura me aftësinë e kufizuar; Shkolla ka aktivizuar komisionin për nxënësit me aftësi të kufizuara dhe ka bashkëpunuar me ZVAP-në; Nxënësit i është caktuar mësuese ndihmëse dhe, më pas, mësuesja është ndryshuar me një profesioniste të pedagogjisë speciale; Prania e prindit në klasë është lejuar përkohësisht si masë mbështetëse; Kufizimi i pranisë së prindit është vendosur për arsye që lidhen me mbarëvajtjen e procesit mësimor, ankesat e komunitetit të klasës dhe ushtrimin e funksioneve nga mësuesja ndihmëse; Shkolla nuk ka vendosur që nxënësi të përjashtohet nga procesi mësimor, por ka kërkuar që ai të frekuentonte me mbështetjen profesionale të caktuar; Për nxënësin është hartuar PEI dhe janë përdorur forma të ndryshme të mësimdhënies dhe vlerësimit; Pas rikthimit në muajin maj 2026, nxënësi ka frekuentuar rregullisht deri në përfundimin e vitit; Nxënësi është vlerësuar në të gjitha lëndët, ka përfunduar klasën VI dhe është pajisur me dëftesë; Nuk është provuar se ndonjë masë, notë, mungesë ose kufizim është vendosur për shkak të aftësisë së kufizuar ose si reagim ndaj statusit prindëror të ankueses.

Në të njëjtën kohë, Komisioneri vlerëson se shkolla duhej të kishte bërë më shumë, veçanërisht në drejtim të **parandalimit të zgjatjes së mosfrekuentimit, ndërmarrjes së masave të hershme për rikthimin e nxënësit, dokumentimit të përpjekjeve të bëra për këtë qëllim dhe verifikimit të saktësisë së të dhënave të pasqyruara në lidhje me mungesat**. Këto elemente janë të rëndësishme për të garantuar që një situatë konflikti ndërmjet prindit dhe institucionit të mos ndikojë në mënyrë të tërthortë në të drejtën e fëmijës për arsimim.

Në këtë kuadër, masat e marra nga shkolla kanë ndjekur qëllime të ligjshme, të tilla si garantimi i së drejtës për arsimim të nxënësit, sigurimi i mbështetjes së specializuar, mbarëvajtja e procesit mësimor dhe mbrojtja e të drejtave të nxënësve të tjerë. Megjithatë, mënyra e administrimit të

situatës dhe, veçanërisht, reagimi ndaj periudhës së zgjatur të mosfrekuentimit, mund të ishte më i shpejtë, më i koordinuar dhe më i orientuar drejt interesit më të lartë të fëmijës.

Komisioneri rithekson se jo çdo mangësi procedurale, mosdakordësi pedagogjike, konflikt institucional ose pakënaqësi ndaj një vendimmarrjeje përbën diskriminim. Për këtë kërkohet që trajtimi i pafavorshëm të jetë i lidhur në mënyrë shkakësore me një nga shkaqet e mbrojtura. Megjithatë, në rastet që përfshijnë nxënës me aftësi të kufizuara, institucionet arsimore kanë një detyrim të shtuar për të vepruar në mënyrë aktive, në kohë dhe të koordinuar, me qëllim që vështirësitë institucionale ose mosmarrëveshjet me prindin të mos shndërrohen në pengesë për ushtrimin efektiv të së drejtës së fëmijës për arsimim.

Diskriminimi përkufizohet në nenin 3, pika 1 të Ligjit 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, si: *“Çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si nga ligjet në fuqi”*.

Diskriminimi karakterizohet nga trajtimi i diferencuar, pra duhet të demonstrohet se viktimat e pretenduar është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme për shkak të një karakteristike që përfshihet në “shkakun e mbrojtur”. Trajtimi më pak i favorshëm përcaktohet me anë të krahasimit ndërmjet viktimës së pretenduar dhe një personi tjetër në një situatë të ngjashme, i cili nuk posedon karakteristikën e mbrojtur.

Për sa më sipër, në referencë të nenit 7/1 të Ligjit 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, Komisioneri gjykon se Shkolla 9-vjeçare “Niket Dardani”, ka zbatuar legjislacionin e sipërcituar, i detyrueshëm për institucionet arsimore dhe se nuk ka ndërmarrë veprime që kanë ekspozuar fëmijën e subjektit ankues ndaj një trajtimi të padrejtë dhe të pafavorshëm.

Në mungesë të këtij trajtimi, Komisioneri arrin në konkluzionin që nuk kemi të bëjmë me një sjellje të paligjshme nga ana e këtij institucioni, për shkakun e pretenduar nga ankuesja dhe për rrjedhojë nuk provohet se Shkolla “Niket Dardani”, Tiranë, ka shkelur dispozitat e ligjit 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar.

PËR KËTO ARSYE :

Bazuar në nenet 32 dhe 33 të ligjit 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I:

1. Konstatimin e mosdiskriminimit të nxënësit D.D.M, i përfaqësuar nga prindi Znj. M.D, nga ana e Shkollës 9-vjeçare “Niket Dardani”, Tiranë.
2. Komisioneri rekomandon që Shkolla 9-vjeçare “Niket Dardani” dhe ZVAP Tiranë të hartojnë një protokoll të shkruar, të qartë dhe të zbatueshëm për praninë e përkohshme të prindit gjatë fazës fillestare të përshtatjes së nxënësit me mësuesin ndihmës. Përcaktimi, vazhdimi ose përfundimi i kësaj mase të bazohet në një vlerësim të plotë dhe periodik të nxënësit nga ekipi multidisiplinor, duke marrë në konsideratë nevojat individuale të fëmijës, nivelin e përshtatjes, ecurinë në procesin mësimor dhe socializimin, si dhe nevojën konkrete për mbështetje nga prindi. Protokollin të përcaktojë kohëzgjatjen, hapat e tërheqjes graduale, kriteret e vlerësimit të gatishmërisë së nxënësit dhe rolin e komisionit shkollor në monitorimin e procesit. Komunikimi ndërmjet shkollës, ZVAP-së dhe familjes të jetë i vazhdueshëm dhe i dokumentuar, me qëllim adresimin në kohë dhe me bashkëpunim të çdo mosmarrëveshjeje që mund të lindë.
3. Komisioneri rekomandon që shkolla të marrë masa të menjëhershme për parandalimin e mosfrekuentimit të zgjatur të nxënësit, duke dokumentuar shkaqet e mosfrekuentimit, masat e ndërmarra për rikthimin e nxënësit dhe bashkëpunimin me prindin dhe strukturat përgjegjëse.
4. Komisioneri rekomandon që shkolla të forcojë bashkëpunimin ndërmjet stafit pedagogjik, mësuesit ndihmës, Shërbimit Psiko-Social, komisionit përkatës, ZVAP-së dhe prindit, me qëllim garantimin e mbështetjes së individualizuar dhe të vijimit të pandërprerë të arsimimit të nxënësit, në përputhje me interesin më të lartë të fëmijës.
5. Komisioneri rekomandon që Shkolla 9-vjeçare “Niket Dardani”, të sigurojë që PEI-të të hartohen, rishikohen dhe zbatohen në mënyrë individuale, mbi bazën e nevojave konkrete të nxënësit dhe vlerësimit të ekipit multidisiplinor, duke garantuar përfshirjen reale të prindit në këtë proces. Mosdakordësitë e prindit duhet të dokumentohen dhe të shoqërohen me një arsyetim të qartë profesional.
6. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

KOMISIONER

Genta TAFA (Bungo)